



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KRYEMINISTRIA**  
**INSPEKTORATI QENDROR**

Inspektorati Qendror, edhe gjatë vitit 2022, ka vazhduar të jetë në krye të misionit të vet për përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së procesit inspektues, duke bashkërenduar veprimtaritë inspektuese, me gjithë vështirësitë e mëdha të krijuara nga sulmi kibernetik, i ndodhur në Korrik të këtij viti. Kjo sfidë e re bëri që të krijoheshin praktika të reja, për vendosjen e veprimtarisë inspektuese të të gjithë inspektorateve shtetërore dhe vendore në linjë për të kryer veprimtarinë e tyre ligjore inspektuese. Në vitin që lamë pas, edhe pse të gjendur para kësaj sfide, ka vijuar pa ndërprerje përkushtimi në përmbushjen e detyrimeve dhe funksioneve të përcaktuara me ligj.

Inspektorati Qendror, si institucioni mbikëqyrës, me përgjegjësinë ligjore për përmirësimin të efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në vend, ka udhëhequr veprimtarinë inspektuese, edhe gjatë periudhës së mosfunksionimit të sistemit elektronik “*e-Inspektimit*”, me qëllim garantimin e zbatimit të kërkesave ligjore në të gjithë subjektet e inspektimit në vend, pa e ndërprerë veprimtarinë inspektuese dhe duke hartuar e zbatuar ndryshimet përkatëse.

Me gjithë situatën e krijuar, inspektoratet shtetërore, nën udhëheqjen dhe koordinimin e Inspektoratit Qendror, kanë realizuar objektivin kryesor për kryerjen e veprimtarisë inspektuese, ku për një periudhë të shkurtër, deri në vënien në efikasitet të sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”, inspektimet janë kryer manualisht, por me kushtin që edhe këto procedura të ishin pjesë e sistemit online të inspektimit, në momentin e parë që ky sistem të fillonte të funksiononte. Për të gjithë pjesën tjetër veprimtaria inspektuese është zhvilluar online, nëpërmjet sistemit me dokumente standarde, listë-verifikimi, nënshkrim elektronik dhe me sistem GPS dhe Regjistrim Video &Audio.

Inspektorati Qendror, nëpërmjet unifikimit të procesit inspektues, ka rritur në mënyrë të ndjeshme transparencën e procedurave të inspektimit dhe ka në fokus ngritjen e vazhdueshme profesionale të inspektorëve shtetërorë dhe vendorë, me synim rritjen e mëtejshme të besueshmërisë së publikut ndaj procesit inspektues. Sfidë ka qenë edhe bashkërendimi i veprimtarisë inspektuese për inspektoratet shtetërore të krijuara rishtas apo ato të riorganizuar, për mbulimin e veprimtarisë inspektuese për fushat e tyre të inspektimit, shmangien e mbivendosjeve të veprimtarisë së tyre, si dhe rritjen e efektivitetit të veprimtarisë inspektuese për këto inspektorate. Për këtë qëllim Inspektorati Qendror ka marrë masat e duhura procedurale dhe aktet e nevojshme për përshtatjen e funksioneve e tyre inspektuese sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Inspektorati Qendror, në kuadër të objektivave të vet strategjike, atë të ofrimit të ndryshimit rrënjësor në veprimtaritë inspektuese në vend, ka ndërmarrë iniciativën dhe ka propozuar ndryshimet në ligjin për inspektimin. Nisur edhe nga situatat me të cilat jemi përballur deri tani, ndryshimet ligjore të kërkuara edhe nga dhomat e biznesit vendase e të huaja, të cilat janë edhe pjesë e strategjive të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, kanë për qëllim të nxisin masat për të luftuar politizimin dhe korrupsionin në radhët e inspektorëve, ngritjen e procesit të rekrutimit dhe karrierës profesionale të trupave inspektuese, duke forcuar politikën dhe legjislacionin me qëllim përmbushjen e standardeve për integrimin në BE.

Inspektorati Qendror, synon arritje të mëtijshme të objektivave të veta, në funksion të përmbushjes së detyrimit ligjor dhe misionit në fushën e veprimtarive inspektuese, me qëllim që gjatë punës tonë të rrisim dhe forcojmë besimin e qytetarëve në përmirësimin e cilësisë së jetës, formalizmin e ekonomisë, përmirësimin dhe lehtësimin e procedurës administrative të inspektimit, si dhe t'u garantojmë atyre ruajtjen me transparencë dhe përkushtim të burimeve dhe aseteve natyrore të vendit tonë.

Inspektorati Qendror ka si qëllim kryesor që nëpërmjet veprimtarisë inspektuese, të arrijmë të normalizojmë bizneset dhe t'i krijojmë hapësirë konkurrencës së ndershme, e cila do të garantojë rritje ekonomike të qëndrueshme në vend, si pjesë e zbatimit të reformave ekonomike cilësore, e shoqëruar me riorganizimin përmbajtësor të inspektorateve dhe ndryshimeve ligjore përkatëse.

Në emër të stafit, qytetarëve, bizneseve që na kanë besuar, si dhe partnerëve ndërkombëtarë, besojmë se iniciativa për të krijuar një platformë të re me standarde bashkëkohore evropiane në fushën e inspektimeve, do të jetë sfida dhe qëllimi ynë kryesor, për përmbushjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe marrëveshjeve ndërkombëtare ku vendi ynë është palë.

## **INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

**SHKËLQIM HAJDARI**



## TABELA E PËRMBAJTJES

Mesazhi i Inspektorit të Përgjithshëm.....	1
Legjenda e Institucioneve .....	4
I. Hyrje.....	5
II. Qëllimi.....	8
III. Metodologjia.....	9
IV. Objektivat.....	10
V. Veprimtaria e Inspektoratit Qendror për Vitin 2022.....	11
VI. Raportimi i veprimtarisë së trupave inspektuese sipas ministrive të linjës.....	13
1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave .....	13
2. Ministria e Punëve të Brendshme .....	14
2.1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit .....	14
3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë.....	16
3.1. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore .....	16
3.2. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut .....	18
4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.....	20
4.1. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.....	20
4.1.1. Drejtoria e Inspektimit të Naftës e Gazit dhe Nënprodukteve.....	20
4.1.2. Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion.....	21
4.1.3. Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike.....	21
4.1.4. Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare.....	21
4.1.5. Drejtoria e Labororit Qendror të Kontrollit.....	21
4.2. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera.....	23
4.3. Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor.....	24
5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.....	25
5.1. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.....	25
6. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.....	26
6.1. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.....	26
6.2. Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës.....	29
7. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	31
7.1. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.....	31
7.2. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.....	32
7.3. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet.....	34
8. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.....	35
8.1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit.....	35
8.2. Agjencia Kombëtare e Bregdetit.....	37
VII. Raportimi i Veprimtarisë për Inspektoratet Vendore.....	39
VIII. Raport Monitorimi i Buxhetit për Vitin 2022, Inspektorati Qendror.....	39
IX. Konkluzione.....	41
X. Rekomandime.....	43

## Legjenda e Institucioneve

AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
AKBPM	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKSEM	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
DIH	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
DINGN	Drejtoria e Inspektimit të Naftës e Gazit dhe Nënprodukteve
DIPIE	Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike
DIPNP	Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion
DSGIK	Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare
DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DPI	Drejtoria e Pronësisë Intelektuale
DSHPA	Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës
DT	Drejtoria Teknike
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
IQ	Inspektorati Qendror
ISHMT	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
ISHPSHSH	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
ISHTI	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
OMP	Organizata e Menaxhimit të Peshkut
QNOD	Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare
VNM	Vlerësimi i ndikimit në mjedis
ZMR	Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

## I. HYRJE

Inspektorati Qendror, bazuar në ligjin 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, udhëheq procesin e inspektimit me funksione mbikëqyrëse, koordinuese, monitoruese, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive inspektuese.

Për këtë, referuar zbatimit të planit të veprimit të vitit 2022, ka bashkëpunuar me inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese për kryerjen e inspektimeve online nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, për të siguruar programimin e inspektimeve, bazuar mbi vlerësimin e riskut, dokumentimin e veprimtarisë inspektuese konform ligjit dhe akteve të tjera nënligjore, për identifikimin e problematikave dhe adresimin për zgjidhjen e tyre, lidhur me përmirësimin e bazës ligjore, logjistikës, ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Përgjatë periudhës Korrik-Gusht 2022, për shkak të sulmit kibernetik, pati një ndikim në ecurinë e punës për arritjen e objektivave, lidhur me kryerjen e inspektimeve online nga sistemi. Inspektorati Qendror për të mos ndërprerë procesin inspektues rekomandoi kryerjen e inspektimeve me akte administrative në formë të printuar.

Çdo vit, Inspektorati Qendror, është përpjekur që standardet unifikuese të veprimtarisë së inspektimit të gjejnë zbatim nga të gjitha inspektoratet shtetërore, por për vitin 2022, nga 16 inspektorate shtetërore, 3 prej tyre nuk arritën t’i zbatojnë këto standarde për kryerjen e inspektimeve online nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, pranë dhe në prani të biznesit, si një element i rëndësishëm për rritjen e transparencës.

Me gjithë arritjet e deritanishme, mbetet ende shumë punë për të përmirësuar procesin inspektues dhe për të rritur besueshmërinë e publikut, uljen e korrupsionit dhe barrës administrative ndaj biznesit, si dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore inspektuese.

Siç e kemi raportuar edhe në vitet e mëparshme këto 3 trupa inspektuese janë: (1) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në fushën e ndërtimeve të paligjshme dhe produkteve të ndërtimit; (2) Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, vazhdojnë të mos kryejnë inspektime online, konform rregullave të përcaktuara, pavarësisht se Inspektorati Qendror ka siguruar tashmë infrastrukturën e duhur, pra implementimin në sistem të dokumenteve standarde, pajisjen me tabletë, si dhe trajnimin e të gjithë trupës inspektuese; (3) Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, është në proces lidhur me implementimin në sistem të dokumenteve standarde dhe listë-verifikimeve.

Gjatë vitit 2022, Inspektorati Qendror në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile bëri të mundur krijimin e infrastrukturës së domosdoshme (përshtati dokumentet standarde, listë-verifikimet dhe siguroi pajisjen me tablet) për kryerjen e inspektimeve online dhe aktualisht ky inspektorat shtetëror zhvillon procedurën nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”.

Inspektorati Qendror, si institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e inspektorateve shtetërore për zbatimin e legjislacionit në fuqi për inspektimin, edhe për gjatë vitit 2022, konstatoi se

procesi inspektues përgjithësisht ushtrohej konform ligjit për inspektimin, por me disa mangësi lidhur me: programimin dhe realizimin e programit të inspektimit, autorizimin e inspektimit, si dhe kryerjen e procedimit të inspektimit, ku për përmirësimin e tyre janë dhënë rekomandime sipas fushave të inspektimit, që mbulon secili inspektorat shtetëror.

Inspektorati Qendror në bashkëpunim me inspektoratet shtetërore, në të cilat marrëdhënia e punësimit rregullohet sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, pati si objektiv të rëndësishëm ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore të inspektimit, nëpërmjet trajnimit dhe testimit fillestar/periodik ku u vlerësuan 24 inspektorë në testimet fillestare dhe 137 inspektorë në testimin periodik. Gjithashtu, u ri trajnuan edhe 115 inspektorë për kryerjen e veprimtarisë inspektuese online për përdorimin e sistemit “*e-Inspektimi*”, nëpërmjet pajisjes tablet.

Përgjatë vitit 2022, Inspektorati Qendror siguroi shpërndarjen e 20-pajisjeve tabletë shtesë për Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, për kryerjen e inspektimeve online nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”.

Inspektorati Qendror, sipas kreut V, të VKM nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”, ka përditësuar dhe mbajtur Regjistrin Kombëtar të inspektorëve në detyrë për inspektoratet shtetërore dhe për inspektoratet vendore, bazuar kjo në listat dhe informacionin e përgjithshëm të dërguar nga inspektoratet shtetërore.

Për vitin 2022, u pajisën me karta inspektori 153 inspektorë, si detyrim ligjor për Inspektoratin Qendror dhe inspektorin, i cili gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, identifikohet me kartën e inspektorit.

Gjatë vitit 2022, në zbatim të ligjit nr. 10433/2011, me mbështetjen metodologjike të Inspektoratit Qendror dhe në bashkëpunim me bashkitë ka përfunduar përshtatja e dokumenteve standarde të inspektimit dhe hartimi i listë-verifikimeve për 42 njësi vendore, ku tashmë të gjitha këto akte administrative janë implementuar në sistemin elektronik “*e-Inspektimi*”.


Gjatë vitit 2022, Inspektorati Qendror ka hartuar dhe dërguar për propozim 3 projektakte, dhe konkretisht projektligjin “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 696, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”, si dhe projektvendimin “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në procesin e inspektimit”. Gjithashtu, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për konsultimin publik, nga ana e Inspektoratit Qendror është realizuar dhe përfunduar procesi i takimeve konsultative dhe konsultimi publik në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, për projektligjin për inspektimin.

Nga analiza e brendshme e kryer rezulton se ka patur problematika të evidentuara lidhur me zhvillimin e procesit inspektues online, si:

- Ndërhyrja e herë pas hershme në sistemin “*e-Inspektimi*” për përmirësimin e politikave të sigurisë, ka sjellë pengesa në veprimtarinë inspektuese të inspektorëve;
- Vonesa nga OE për zgjidhjen e problematikave të konstatuara në kohë nga përdorimi i sistemit “*e-Inspektimi*”;
- Sulmi kibernetik për periudhën kohore Korrik-Gusht 2022, ka sjellë kryerjen e veprimtarisë inspektuese me dokumente të printuara dhe jo nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”;
- Veprimtaria inspektuese nuk u realizua në të gjitha rastet me tabletë nga trupat inspektuese, për mungesë përgjegjësie nga ana e tyre;
- Mungesa e strukturave TIK pranë ISH-ve, ka sjellë ngarkesë të volumit të punës të strukturave TIK pranë IQ;
- Mospërputhja e programeve të miratuara me ato të gjeneruara në sistem, duke sjellë mos realizimin e numrit të inspektimeve të programuara, si rezultat i mos programimit të rregullt të veprimtarisë inspektuese;
- Mungesa e infrastrukturës për pajisjen tablet për t’u siguruar njësi vendore instrumentet për zhvillimin e inspektimeve online;
- Mungesa në kapacitete inspektuese ka sjellë disa mangësi në procedurën inspektuese, si dhe në realizimin e programit të inspektimit;
- Mbivendosje kompetencash institucionale, midis inspektorateve shtetërorë dhe vendore, në disa fusha inspektimi, ka sjellë mangësi në veprimtarinë inspektuese për mbulimin e këtyre fushave të inspektimit.


Gjatë vitit 2022, inspektoratet shtetërore kanë kryer gjithsej 68593 inspektime online nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, nga të cilat 51140 janë të programuara dhe 17453 janë jashtë programit.

Në grafikun më poshtë paraqiten inspektimet e realizuara në vitin 2022 krahasuar me ato të realizuara në vitin 2021, për të gjitha Inspektoratet Shtetërore.






### Inspektime të programuara dhe jashtë programi 2022 krahasuar me 2021




Për shkeljet e konstatuara, për vitin 2022 inspektoratet shtetërore kanë marrë gjithsej 1353 masa administrative “gjobë”, ndërsa për vitin 2021 janë marrë 964 masa administrative gjobë, ose e shprehur në përqindje rreth 42 % masa më shumë, sipas paraqitjeve grafike në vijim:

### Masa Administrative Gjobë 2022





## Masa Administrative Gjobë 2022 krahasuar me 2021



## II. QËLLIMI

Ky raport ka si qëllim pasqyrimin me objektivitet të aktiviteteve të zhvilluara përgjatë vitit 2022, për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjet sektoriale, si dhe aktet e tjera nënligjore, për kryerjen e veprimtarisë së inspektimit, si një proces i rregullt administrativ.

Nisur nga fakti se inspektimi është një ndër faktorët më të rëndësishëm në mbrojtjen e interesit publik, Inspektorati Qendror, si autoritet përgjegjës në fushën e inspektimeve, edhe përgjatë vitit 2022, ka punuar me përkushtim dhe përgjegjshmëri për rritjen e nivelit të zbatueshmërisë së legjislacionit, rritjen e transparencës së procesit inspektues, integritetin e inspektorëve, si dhe për të siguruar një cilësi më të lartë të jetës dhe shëndetit për konsumatorin.

Inspektorati Qendror, referuar planit të veprimit 2022, bën të njohur kryerjen e aktiviteteve, të cilat konsistojnë kryesisht në:

- Kryerjen e veprimtarisë inspektuese online, me procedurë standarde nga të gjitha inspektoratet shtetërore, në përputhje me ligjin për inspektimin dhe ligjet sektoriale, me tabletë dhe me GPS, nëpërmjet sistemit unik të inspektimit “*e-Inspektimi*”;
- Zbatimin e Programit vjetor/mujor të inspektimit, bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut, në formë elektronike nga sistemi unik “*e-Inspektimi*”;
- Përditësimin e listë-verifikimeve të inspektorateve shtetërore dhe implementimin e tyre në sistemin unik “*e-Inspektimi*”;
- Bashkërendimin e programeve të inspektimit, me qëllim kryerjen e inspektimeve të përbashkëta;
- Mbikëqyrjen e veprimtarisë inspektuese, nga inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese në përputhshmëri me ligjin për inspektimin dhe ligjet sektoriale dhe prezantimin e devijimeve në veprimtarinë inspektuese, e rekomandimin në kohë, për marrjen e masave nga inspektoratet shtetërore;
- Ngritjen e kapaciteteve dhe integritetin e inspektorëve nëpërmjet trajnimit dhe testimit fillestar dhe periodik, ku marrëdhënia e punës rregullohet sipas Kodin të Punës;
- Hartimin dhe implementimin e dokumenteve standarde dhe listë-verifikimeve për fushat e veprimtarisë inspektuese për 42-njësi bashkiake;
- Implementimin në sistemin “*e-Inspektimi*” të inspektorateve të reja të krijuar rishtasi apo të riorganizuara;
- Trajtimin me përparësi të kërkesave për informacion dhe ankesave të qytetarëve apo subjekteve të inspektimit, në lidhje me veprimtarinë inspektuese dhe shqyrtimin e saj;
- Hartimin e projekteve dhe dërgimin e tyre për propozim, projektligji “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 696, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”, si dhe projektvendimi “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në procesin e inspektimit”;

- Realizimin dhe përfundimin e procesit të takimeve konsultative dhe konsultimin publik në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, për projektligjin “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

### III. METODOLOGJIA

Inspektorati Qendror, në zbatim të ligjit nr. 10433/2011 dhe VKM nr. 696/2013, është përgjegjës për përgatitjen e raportit të përgjithshëm vjetor të inspektimeve, në përputhje me kërkesat e ligjit për inspektimin dhe ligjeve sektoriale, duke siguruar mbledhjen e të dhënave të nxjerra nga sistemi “*e-Inspektimi*”, raportimin vjetor të vënë në dispozicion nga inspektoratet shtetërore, si dhe akte të tjera administrative që rregullojnë procesin inspektues.

Procedura e mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, konsiston në analizën e modulit të programimit, çështjeve të inspektimit, raporteve dhe statistikave të veprimtarisë inspektuese, regjistrin të gjobave, etj., duke shqyrtuar dhe analizuar dokumentacionin përkatës të administruar në sistem, përfshirë këtu: programin vjetor të inspektimit, programet mujore të inspektimit, autorizimin, listë-verifikimet, procesverbalin e inspektimit, vendimin përfundimtar, të dhënat nga regjistri i gjobave, si dhe dokumente të tjera justifikuese të përdorura gjatë veprimtarisë inspektuese.

Të dhënat e analizuar janë marrë nga moduli “Raporte” dhe “Moduli i çështjeve të inspektimit”, me anë të filtrave “hapur nga” dhe “mbyllur deri”, për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022.

Një tjetër element i rëndësishëm është edhe informacioni i marrë nëpërmjet raportimit të veprimtarisë së inspektorateve shtetërore, të paraqitura pranë Inspektoratit Qendror, si dhe analizat e veprimtarisë vjetore të inspektimit të vitit 2022, të kryera nga të gjitha inspektoratet shtetërore, ku është trajtuar materiali në bazë të problematikave të hasura, zgjidhjeve të dhëna, rezultateve të arritura, si dhe objektivat e tyre për të ardhmen.

Në vijim të këtij Raporti pasqyrohen në formë të përmbledhur, arritjet, problematikat, objektivat, për Inspektoratin Qendror, për inspektoratet shtetërore/trupat e tjera inspektuese, konkluzionet dhe rekomandimet për përmirësimin e veprimtarisë inspektuese.

#### IV. OBJEKTIVAT

Inspektorati Qendror ka mision përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive inspektuese, dhe për vitin 2023 ka përcaktuar objektiva të qartë, që kanë të bëjnë me përmirësimin dhe rritjen e transparencës së procesit inspektues, koordinimin, mbështetjen dhe sigurimin e infrastrukturës për kryerjen e inspektimeve online, mbikëqyrjen dhe ndërhyrjen në kohë me rekomandime për mangësitë e konstatuara gjatë procesit të inspektimit.

Këto objektiva konsistojnë në:

- ✓ Kryerjen e inspektimeve online në sistemin “*e-Inspektimi*”, si një proces i rregullt administrativ, nga të gjitha inspektoratet shtetërore;
- ✓ Programimin e inspektimeve mbi bazë tematike dhe vlerësimi i riskut, duke bërë të mundur uljen e numrit të inspektimeve të panevojshme dhe duke zvogëluar kostot administrative ndaj biznesit;
- ✓ Bashkërendimin e veprimtarisë inspektuese në tërësinë e komponentëve të saj, si dhe koordinimin e planeve mujore të inspektimit për të realizuar inspektime të përbashkëta;
- ✓ Rritjen e transparencës së procesit inspektues për të siguruar besueshmërinë e publikut;
- ✓ Mbështetjen nga ana metodologjike për inspektoratet shtetërore për përditësimin e listë-verifikimeve dhe dokumenteve standarde, në varësi të ndryshimeve ligjore;
- ✓ Mbikëqyrjen e veprimtarisë inspektuese online, nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, ku të identifikojë arritjet, problematikat dhe të rekomandojë përmirësimin e procesit inspektues;
- ✓ Mbështetjen e IKMT, DPAP dhe AKVMB, për kryerjen e inspektimeve online në sistemin elektronik “*e-Inspektimi*”;
- ✓ Implementimin në sistemin “*e-Inspektimi*” të inspektorateve të reja apo të ristrukturuara, shtetërore apo vendore, për përmbushjen nga ana e tyre të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi për inspektimin;
- ✓ Rritjen e performancës, integritetit dhe profesionalizmit të trupave inspektuese nëpërmjet trajnimeve dhe testeve;
- ✓ Mbështetjen metodologjike dhe bashkëpunimin me njësitë e qeverisjes vendore për fillimin e inspektimeve online, nëpërmjet sistemit të inspektimeve “*e-Inspektimi*”;
- ✓ Sigurimin e pajisjeve të nevojshme për plotësimin e nevojave të inspektorateve shtetërore dhe inspektorateve vendore;
- ✓ Trajtimi i kërkesave dhe ankesave me prioritet, në kohë dhe me cilësi.
- ✓ Hartimi dhe dërgimi për propozim i projektakteve në fushën e inspektimit, dhe konkretisht, projektvendimi “Për periudhën maksimale të lejuar të inspektimeve vjetore për kategori të ndryshme të subjekteve të inspektimit, në varësi të madhësisë së subjektit dhe rrezikut të veprimtarisë që kryhet, si dhe mënyrën e llogaritjes së saj”, projektvendimi “Për procedurën për marrjen e mostrave, si dhe metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve në këtë procedurë”, projektvendimi “Për intervalet e testimit periodik, rregullat e hollësishme për procedurën e provimit dhe kriteret përkatëse të vlerësimit në këtë procedurë”;

- ✓ Konsultimi i projektvendimit “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në procesin e inspektimit”, si projektakt i përfunduar në vitin 2022.

## V. VEPRIMTARIA E INSPEKTORATIT QENDROR PËR VITIN 2022

Inspektorati Qendror, edhe përgjatë vitit 2022, nëpërmjet aktiviteteve të kryera në fushën e inspektimit, ka synuar rritjen e performancës së procesit inspektues në tërësinë e komponentëve të tij, duke realizuar këto objektiva:

- ✓ Mbështetjen nga ana metodologjike të 16-inspektorateve shtetërore për hartimin e programit vjetor të inspektimit, bazuar në kritere dhe objektiva të qarta sipas vlerësimit të riskut të subjekteve të inspektimit;
- ✓ Dhënie mendimi dhe mbështetje metodologjike për 14-inspektorate shtetërore lidhur me hartimin e programit mujor të inspektimit mbi bazë subjektesh inspektimi, ku qasja kryesore është inspektim i programuar;
- ✓ Sigurimin e përshtatjes së dokumenteve standarde të inspektimit, përditësimin dhe hartimin e listë-verifikimeve të reja, në përgjigje të kërkesave të inspektorateve shtetërore, sipas ndryshime ligjore përkatëse;
- ✓ Implementimin në sistemin “*e-Inspektimi*”, të dokumenteve standarde të inspektimit dhe listë-verifikimet për Autoritetin Kombëtar të Mbrojtjes Civile, i cili tashmë ka filluar procesin inspektues online;
- ✓ Mbështetje metodologjike për standardizimin e procesit inspektues për Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Agjencinë Kombëtare të Pyjeve dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve;
- ✓ Mbikëqyrjen e veprimtarisë inspektuese për 14-inspektorate shtetërore, duke identifikuar arritjet, problematikat dhe duke dhënë rekomandime për përmirësimin e procesit inspektues;
- ✓ Ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore inspektorë, nëpërmjet trajnimit dhe testimit fillestar/periodik, ku u vlerësuan me testimet fillestare gjithsej 24 inspektorë dhe periodik gjithsej 137 inspektorë;

### *U vlerësuan në Testim fillestar gjithsej 24 inspektorë:*

- ✓ AKU                    12 - vlerësim “kënaqshëm”
- ✓ AKU                    3 - vlerësim “jo kënaqshëm”
- ✓ ISHSH                1 - vlerësim “mirë”

- ✓ ISHSH 3 - vlerësim “kënaqshëm”
- ✓ ISHSH 2 - vlerësim “jo kënaqshëm”
- ✓ ISHTI 1 - vlerësim “mirë”
- ✓ ISHTI 1 - vlerësim “kënaqshëm”
- ✓ ISHTI 1 - vlerësim “jo kënaqshëm”

***U vlerësuan në Testim periodik gjithsej 137 inspektorë:***

- ✓ AKU 2 - vlerësim “shumë mirë”
  - ✓ AKU 107 - vlerësim “mirë”
  - ✓ AKU 16 - vlerësim “kënaqshëm”
  - ✓ AKU 12 - vlerësim “jo kënaqshëm”
- ✓ Për rritjen e performancës së inspektorateve shtetërore gjatë kryerjes së procesit inspektues online në sistemin “*e-Inspektimi*”, nëpërmjet tabletës, janë trajnuar dhe ritrajnuar 115 inspektorë (AKU – 17; ISHSH – 33; ISHMT – 15; AKB – 10; DPAP – 20; AKSEM– 16; ISHTI – 4);
  - ✓ Për të gjitha inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese, në zbatim të pikës 4, të nenit 30, të ligjit nr. 10433/2011, u modeluan dhe u printuan gjithsej 153 karta inspektori, dokumenti që prezanton inspektorin gjatë inspektimit. (AKU – 40; ISHSH – 7; ISHMT – 8; ISHPSHSH – 24; IKMT – 2; DPAP – 11; DPA – 1; ZMR – 1; AKM – 26; AKB – 4; AKSEM – 15; ISHTI – 14).
  - ✓ Referuar VKM nr. 696/2013, është mbajtur dhe përditësuar Regjistri Kombëtar i inspektorëve në detyrë për inspektoratet shtetërore dhe për inspektoratet vendore, bazuar kjo në lëvizjet e burimeve njerëzore inspektuese;
  - ✓ Mbështetje metodologjike, për të përshtatur dokumentet unifikuese të inspektimit dhe implementimin e tyre në sistemin “*e-Inspektimi*”, edhe 42-njësi administrative;
  - ✓ Përgatitja dhe dërgimi për propozim i 3 (tre) projektakteve në fushën e inspektimit, dhe konkretisht projektligji “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 696, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*” dhe projektvendimi “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në procesin e inspektimit”.
  - ✓ Realizimi dhe përfundimi i procesit të takimeve konsultative dhe konsultimin publik në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, për projektligjin për inspektimin;

- ✓ Trajtimi dhe shqyrtimi i rreth 50 kërkesa – ankesa, të administruara në formë shkresore dhe elektronike. Objekti i ankesës kryesisht varion nga kërkesa për shqyrtimin e procedurës inspektuese, ankimi për vendimin përfundimtar të inspektimit, denoncime mbi veprimtaritë e subjekteve tregtare, mos respektimi i konkurrencës së ndershme, etj.;
- ✓ Përditësimi i Programit institucional të Transparencës, sipas detyrimeve që burojnë nga ligji për të drejtën e informimit dhe urdhri nr. 187, datë 18.12.2020, i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- ✓ Përditësimi i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve sipas përcaktimeve në ligjin për të drejtën e informimit dhe urdhrin nr. 188, datë 18.12.2020, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjatë vitit 2022, pranë Inspektoratit Qendror janë administruar 17 kërkesa për informacion, ku 10 prej tyre janë deleguar pranë institucioneve kompetente që administrojnë informacionin e kërkuar dhe 7 janë trajtuar në formë të plotë nga Inspektorati Qendror.
- ✓ Inspektorati Qendror edhe përgjatë këtij ka zhvilluar aktivitete në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional me Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm të Kosovës. Në datën 19 Tetor 2023, në ambientet e Inspektoratit Qendror u zhvilluar tryezë e përbashkët pune me përfaqësues të të dy institucioneve homologe, me qëllim vijimin e procedurave të mëtejshme për hartimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit.




## VI. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS.

### 1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA)

DPA është autoriteti përgjegjës për sigurimin dhe zbatimin e legjislacionit arkivor në rrjetin arkivor të Republikës së Shqipërisë, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”, dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

DPA, nëpërmjet trupës inspektuese ka mbledhur të dhëna arkivore për të gjitha subjektet shtetërore, që përbëjnë rrjetin arkivor kombëtar duke krijuar “Data bazën me institucione” si një sistem mirë menaxhimi, monitorimi dhe mbikëqyrës i veprimtarisë së tyre për ecurinë e punës me dokumentet.

DPA, për vitin 2022, ka planifikuar të inspektonte 300 institucione (subjekte) dhe ka realizuar 252 inspektime, nga të cilat 249 të planifikuara dhe 3 të paplanifikuara, si dhe janë marrë 7 masa administrative “gjobë”, për mos korrigjim të shkeljeve dhe mos zbatim të rekomandimeve brenda afatit kohor të caktuar. Pranë Komisionit të Ankimimit janë ankimuar vetëm 4 gjoba, ku 2 prej të cilave janë revokuar me vendim të Komisionit të Ankimimit, si dhe është arkëtuar vetëm 1 gjobë.



Parregullsitë e konstatuara që përbëjnë kundërvajtje administrative janë: mos ngritja e komisionit të ekspertizës pranë institucionit; mos përpilimi dhe miratimi i listave konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve dhe të pasqyrës emërtuese të çeljes së dosjeve; mos kryerja e përpunimit tekniko-shkencor të dokumenteve me RHK dhe mos dorëzimi i tyre në Arkivin Shtetëror përkatës; mungesa e kushteve teknike për ruajtjen fizike dhe teknologjike të dokumenteve.

**Arritjet:** Përgjatë vitit 2022, DPA, e ka realizuar gjithë veprimtarinë inspektuese të saj online, në përputhje të plotë me ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin sektorial, mbështetur në programin vjetor dhe programet mujore, me dokumente standarde, nëpërmjet tabletave duke bërë të mundur gjurmueshmërinë e procesit

të inspektimit, si dhe me njoftim paraprak ku bashkëlidhet, dokumentacioni për marrjen e autorizimit nga subjekti i inspektuar.

**Problematikat:** Nga mbikëqyrja online e veprimtarisë inspektuese janë konstatuar se ka pasaktësi në procesverbalin e inspektimit në rubrikën orën/kohëzgjatjen e zhvillimit të inspektimit, nuk pasqyrohet në sistem ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar).

**Objektivat për vitin 2023:** Në bazë të programit vjetor të inspektimit, është planifikuar kryerja e inspektimeve në 300 institucione (subjekte), ku të gjitha inspektimet do të vazhdojnë të kryhen online, me tableta. sipas ligjit për inspektimin dhe rregullave të caktuara për veprimtarinë inspektuese. Trupa inspektuese e DPA-së nëpërmjet rrjetit arkivor, si një sistem mirë menaxhimi, monitorimi dhe mbikëqyrës i veprimtarisë së tyre ka ndihmuar në hartimin e planeve vjetore të inspektimit, duke përzgjedhur subjektet për inspektim në bazë të vlerësimit të riskut.

## **2. MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

### **2.1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)**

IKMT është institucion qendror buxhetor publik, në varësi të Ministrisë së Brendshme. IKMT ushtron funksionin saj në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. Me hyrjen në fuqi të VKM nr. 604, datë 20.10.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, është shtuar fusha e përgjegjësisë së saj në “*parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin/inspektimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji*”.


Misioni i Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit është ruajtja dhe siguria e ndërtimeve në Republikën e Shqipërisë, duke siguruar respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionin në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në fushën e mjedisit, pyjeve, burimeve ujore dhe produkteve të ndërtimit, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, të decentralizimit dhe subsidiaritetit, në bazë të ndarjes administrative.

Nga mbikëqyrja rezulton se në periudhën kohore Maj-Dhjetor 2022, Drejtoritë e Mjedisit & Ujërave, si dhe Pyjeve, kanë filluar për 2022, të kryejnë inspektime online në sistemin “*e-Inspektimi*”, të cilat kanë vijuar rregullisht për disa qarqe, duke filluar nga muaji maj i këtij viti, ndërsa Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit, ende nuk kryen inspektime online në sistemin “*e-Inspektimi*”, në kundërshtim me ligjin nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

IKMT ka kryer në total 23612 inspektime, nga të cilat 16846 inspektime të programuara dhe 6766 jashtë programit.

Sipas të dhënave në sistem për muajt maj-dhjetor, janë realizuar **768** inspektime sipas programit dhe **243** inspektime jashtë programit, ndërsa **47** inspektime janë realizuar në formë shkresore. Në regjistrin e gjobave, nga këto inspektime rezultuan **113** çështje me vendim përfundimtar, masë administrative gjobë<sup>1</sup>.

Në sistemin “e-Inspektimi”, nga 12 DRIKMT dhe DPIKMT janë **programuar 937** inspektime, ndërsa nga Inspektorati Qendror janë **dakordësuar 1564** inspektime.



Për periudhën 15 Korrik-Gusht (gjatë sulmit kibernetik të rrjetit të sistemeve shtetërore) janë gjeneruar në sistem 53 procedura inspektimi dhe sipas raportimeve të 12 DRIKMT-ve dhe DPIKMT, 47 procedura inspektimi, janë realizuar në formë shkresore.


Në regjistrin e gjobave të sistemit “e-Inspektimi” rezultuan **113 Vendime Përfundimtare me masë administrative gjobë**.

Sipas raportimit të IKMT, ku përfshihet edhe Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit, për periudhën (Janar-Dhjetor) 2022, janë mbajtur 545 vendime gjithsej, nga të cilat:

- 239 vendime për “Prishje objekte te kundërligjshëm” dhe “Pezullim të punimeve në ndërtim”;
- 144 vendime për “Dënim me gjobë” të vëna në fushën e ndërtimeve pa leje;
- 18 vendime për “Dënim me gjobë” të vëna mbi zbatimin e ligjshmërisë tek produktet e ndërtimit/burimet ujore;
- 7 vendime për “Dënim me gjobë” të vëna ndaj kryeinspektorëve/inspektorëve pranë IMT-ve të bashkive për veprime/mosveprime të tyre.
- 137 vendime për “Dënim me gjobë” të vëna në fushën e mjedisit, ujërave dhe pyjeve.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Pa patur informacion për masa administrative të mundshme në çështjet e realizuara në formë shkresore.

<sup>2</sup> Rezultatet e inspektimeve me masë administrative, përfshijnë edhe procedurat përpara fillimit të inspektimeve në sistemin online “e-Inspektimi”.



**Arritjet:** Përveç inspektimeve të realizuara në territor, në përputhje me përcaktimet ligjore sipas fushës së vet të përgjegjësisë, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka ndërmarrë veprime në kuadër të zbatimit të projekteve madhore të Qeverisë Shqiptare, si më poshtë:

- Projekti Infrastrukturalor “Unaza e madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri Shkozë”;
- Realizimi i projekteve kombëtare.

**Objektivat për vitin 2023:** Konfiskimi si proces për strehim social apo interes publik, të objekteve të ndërtuara pa leje për qëllim fitimi, vjen si një proces i ri për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, i cili po vijon me intensitet të plotë. IKMT-ja është hallke e rëndësishme e këtij procesi për identifikimin dhe dërgimin e dokumentacionit përkatës të objekteve pa leje, sipas përcaktimeve ligjore pranë AZHT-së në cilësinë sekretariatit teknik të KKT-së. Vija Bregdetare: Evidentimi, procedimi dhe prishja e ndërtimeve pa leje/me leje (pas trajtimit sipas legjislacionit) konkretisht në zona të brezit të zhvillimit të kontrolluar dhe zonave me përparësi të turizmit. Krimi Mjedisor: Mbrojtja e territorit nga krimi mjedisor është një sfidë e vazhdueshme për institucionin, ku përveç ndëshkimit me masë administrative të subjekteve, vazhdon bashkëpunimi për procedimin penal të kundërvajtësve.

**Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”:** IKMT, Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit, nuk kryen veprimtaritë inspektuese në sistemin unik të inspektimeve “e-Inspektimi”, në zbatim të ligjit nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhrit nr. 6, datë 19.02.2015, të Inspektorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”, Urdhrit nr. 25, datë 10.8.2018, “Për miratimin e rregullores, “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, i ndryshuar si dhe në zbatim të VKM nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi” për inspektimet e kryera nga Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit; nuk kryen veprimtaritë inspektuese (të inspektimit apo edhe riinspektimit) me *tabletë*, në platformën unike të inspektimit “e-Inspektimi”, në vendin ku subjekti kryen aktivitet, nuk dokumentohet

në dosjen e çështjes përkatëse autorizimi me firmën dhe vulën e Kryeinspektorit, si dhe njoftimi i tij subjektit, objekt inspektimi; Procesverbalit i inspektimit nuk duhet të mbahet jashtë afateve të parashikuara në Autorizim sipas përcaktimeve në pikën 1, të nenit 29, të ligjit nr. 10433/2011; nuk nënshkruhen nga inspektorët e trupës së inspektimit dhe nga personi i autorizuar i subjektit dokumentet standarde në sistem, si kusht për vlefshmërinë e tyre, në përfundim të inspektimit, në zbatim të pikës 4, të shtojcës 2, të urdhrin nr. 25/2018, të ndryshuar; nuk mbahen bashkëlidhur në dosje, dokumentacioni justifikues për konstatimet në subjekt me ose pa gjetje, realizimin e detyrave të lëna nga inspektimi i mëparshëm, marrjen e njoftimit të procesverbalit, shpjegimet apo kontestimet e subjektit mbi gjetjet e konstatuara në procesverbal (nëse ka), në përputhje me pikën 6, të shtojcës 2, të Rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, miratuar me urdhrin nr. 25/2018, të ndryshuar; nuk merret sipas parashikimeve në pikën 2, të nenit 43, të ligjit 10433/2011, masa urgjente me vendim të ndërmjetëm; nuk dokumentohet marrja/njoftimi i vendimit të Komisionit të Ankimit, i nënshkruar dhe vulosur nga Kryeinspektori, si dhe ecuria papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti, për çështjet me vendim përfundimtar me masë administrative *gjobë*.

**Problematikat:** IKMT, Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit, ende nuk kryen inspektime online në sistemin “e-Inspektimi”, në kundërshtim me ligjin nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. IKMT ka hasur problematikë në lidhje me identifikimin e subjekteve posedues apo prona të inspektuara, marrjen e informacioneve nga autoritetet planifikuese dhe inspektuese të qeverisjes vendore, në lidhje me dokumentacionin mbi ligjshmërinë e objekteve/ndërtimeve të inspektuara.

Problematike ka qene situata në lidhje me konfiskimet sipas VKM nr. 589, datë 07.09.2022, “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, i cili është një proces i ri që fillon nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

### **3. MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

#### **3.1. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)**


ISHPSHSH është struktura përgjegjëse për të siguruar respektimin e kërkesave ligjore në fushën e legjislacionit të punës dhe atë të shërbimeve shoqërore. ISHPSHSH-ja, ushtron funksionet e saj në zbatim të VKM nr. 295, datë 20.3.2013, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”. Veprimtaria inspektuese është e strukturuar në 6 rajone, si dhe Drejtoria e Përgjithshme, inspektorët e së cilës kryejnë veprimtari inspektuese në raste të ngjarjeve në respektimin e legjislacionit të punës.

ISHPSHSH numëron gjithsej 165 pozicione pune, por aktualisht operon me veprime inspektuese me staf prej 94 inspektorësh në terren, 13 sektorë inspektimi, të cilat janë të organizuara në 6 drejtori rajonale.


ISHPSHSH për vitin 2022, ka kryer në sistemin “e-Inspektimi” 9974 inspektime gjithsej, nga të cilat 5517 të programuara dhe 4457 jashtë programit, por pjesë e inspektimeve të evidentuara si çështje inspektimi jashtë programi janë edhe ato të kryera si program inspektimi gjatë periudhës së sulmit kibernetik, deri në stabilizimin e veprimtarisë inspektuese të programuar në Nëntor 2022.

Për vitin 2022, janë realizuar 10154 inspektime gjithsej nga ISHPSHSH, ku 9974 janë kryer nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi”, ndërsa 180 inspektime janë kryer manualisht, gjatë sulmit kibernetik mbi sistemin online.

Grafiku më poshtë, pasqyron inspektimet e realizuara sipas sektorëve të ISHPSHSH-së, inspektimet e programuara në raport me inspektimet jashtë programit.



Gjatë veprimtarisë inspektuese janë vendosur 2399 masa administrative në subjektet e inspektuara ose në 23.6 % të subjekteve të inspektuara, ku 940 janë masa urgjente për shkelje të marrëdhënieve të punës, 98 janë masa urgjente për shkelje të sigurisë dhe shëndetit në punë, 1 226 janë masa të dënimit kryesor “paralajmërim” dhe 135 janë masa të dënimit kryesor “gjobë”, në përqindje ndarë sipas tabelës në vijim:



ISHPSHSH për vitin 2022 ka vendosur 135 masa administrative “gjobë” për shkelje të konstatuara:

- ✓ 48 gjoba gjatë inspektimeve për shkak aksidente në punë;
- ✓ 32 gjoba gjatë inspektimeve për shkak ankese, denoncime nga të tretët;
- ✓ 54 gjoba në inspektime të programuara dhe tematike;
- ✓ 1 gjobë në inspektime rastësore.

Komisioni i Ankimit të ISHPSHSH ka shqyrtuar 46 raste ankimimi të vendimit përfundimtar nga të cilat: 35 raste janë lënë në fuqi; 10 raste janë ndryshuar; 1 masë administrative “gjobë” është rrëzuar. Nga këto 46 raste ankimi, 41 janë inspektime me dënim administrativ “gjobë” për të cilat: 31 janë lënë në fuqi; 7 janë ndryshuar në “paralajmërim”; 2 janë ulur masa e gjobës; 1 shfuqizuar.

Për vitin 2022, arkëtimet nga gjobat janë në vlerën prej 18.019.708 (tetëmbëdhjetë milion e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë, nga të cilat 17.652.470 lekë janë të ardhura nga gjobat dhe 367.238 lekë janë të ardhurat nga kamatë vonesat.

**Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”:** ISHPSHSH hartoi program vjetor inspektimi për vitin 2022, sipas formatit të përcaktuar ligjor, brenda afatit ligjor të përcaktuar, sipas një metodologjie risku, të hartuar nga vetë ISHPSHSH; Programet mujore të inspektimit janë hartuar me subjekte inspektimi; Realizon procedurën e inspektimit online, me dokumente standarde dhe listë verifikimi, kryesisht me tabletë, por në disa rajone procedura e inspektimit është realizuar pa tabletë, në Rajonet Shkodër, Dibër dhe Gjirokastrë; Dokumentacioni i veprimtarisë inspektuese, ka mangësi në plotësimin e tyre apo nuk mbahet në vendin e caktuar në Autorizimin e inspektimit, pranë subjektit të inspektimit, por në zyrat e ISHPSHSH (konstatuar sidomos për Rajonin Tiranë). Në Autorizimin e inspektimit, përshkrimi i objektit të inspektimit nuk bëhet i plotë, pasi nuk përshkruhet objekti i saktë i inspektimit - Vendimi përfundimtar i inspektimit, në shumicën e rasteve, nuk merret pranë subjektit të inspektuar me përfundimin e inspektimit, por merret në një kohë të mëvonshme, pa arsye ligjore të evidentuar, megjithëse është i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për ta marrë këtë vendim sapo të përfundojë procedura e inspektimit - Vendimi Përfundimtar i Inspektimit kur konstatohet shkelja e kërkesave ligjore, merret masë administrative, në përputhje me matricën e dënimeve administrative, të hartuar nga ky inspektorat.

**Arritje:** Listë verifikimi e dedikuar sektoriale në aktivitetet e fasonerisë, ndërtimit, dhe agjencive private të punësimit; përdorimi i masës urgjente, si mjet efikas në rregullshmërinë e shkeljeve ligjore të legjislacionit të punës, duke siguruar 99.2% e punëmarrësve të evidentuar në punë krejtësisht të pambrojtur, si dhe nga ana shoqërore e shëndetësore. Inspektimet për informalitetin gri, orientuar drejt vlerësimit të kontratave të punës, duke ndërhyrë drejtpërsëdrejti në fenomene që sjellin punë të papaguar në turne të dyta, të treta, mos pagesë për orë shtesë, etj; ndërgjegjësimi mbi të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit, nëpërmjet takimeve informuese dhe këshilluese në subjekte me numër të lartë punëmarrësish, kryer për mbi 9073 punëmarrës dhe 282 punëdhënës; përfshirja aktive dhe e



qenësishme në luftën kundër informalitetit; vlerësimi i sektorit fason, me risk mesatar në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore të marrëdhënieve të punës, ri dimensionimi i procesit inspektues pati impaktet e veta në formalizimin e marrëdhënies së punës në zbatim të ligjit, përfshirë jo vetëm sigurimin e tyre në skemën e sigurimeve shoqërore, por dhe të drejta të mohuara për shkak të mos funksionimit të elementëve për punë të denjë e që flasin për informalitet gri; sezonin turistik, dhe kontrolli i sektorit Hotel-Bar-Restorante, tashmë pjesë e vëmendjes së inspektimit, pati impaktin e vet, për më shumë punë të denjë e të drejta për t'u zbatuar, konform një marrëdhënie pune të shëndetshme; agjencitë private të punësimit dhe vëmendja e ISHPSHSH-së në këtë sektor, janë një tjetër arritje e vitit 2022. Verifikimi i standardeve të rekrutimit të punëkërkesve sipas legjislacionit të fuqi, u bënë pjesë e punës inspektuese dhe një vëmendje e shtuar e ISHPSHSH-së ndaj këtij sektori dhe në të ardhmen.

**Problematika:** Ka hasur problematika në zbatimin e kërkesave ligjore në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë; mungesa e informimit të punëmarrësve; mosfunksionimi real i KSSHPI në të shumtën e rasteve; aktiviteti i ndërgjegjësimit të punëdhënësve në respektimin e të drejtave dhe detyrimeve mes palëve; mungesë koordinimi nëpërmjet platformave të ndryshme për të denoncuar punën informale; mangësi për kontrollin në shërbimet e kujdesit shoqëror; mangësi në sisteme funksionale të integruara të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe shëndetësor në njësitë e qeverisjes vendore; mungesa e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel kombëtar; kapacitete jo të plotësuara të Drejtorisë së Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore; mangësi në pajisjen me licencë për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

**Objektivat për vitin 2023:** Rritja e cilësisë së inspektimit përmes përmirësimit të programimit të inspektimit mbi bazë risku, monitorim dhe bashkëpunim ndërinstytucional; përmirësimi i mëtejshëm dhe shtimi i funksionaliteteve nëpërmjet zhvillimeve të reja të “Platformës Ndërgjegjësuese” me mbështetjen e projektit ESAP2; forcimi i integritetit dhe etikës institucionale; zhvillimi i ndërhyrjeve dhe objekteve të përcaktuara në Strategjinë Punësim dhe Aftësim 2023-2030; implementimi i ndryshimeve ligjore në praktikën inspektuese të ISHPSHSH-së; promovimi i kulturës parandaluese për vende pune të sigurt, të shëndetshme dhe produktive; Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore në partneritet me UNICEF dhe UNDP, në kuadër të Programit 4 vjeçar “Leave No One Behind” LNB2, për vitin 2023, ka dakordësuar dhe do të realizojë aktivitete të përbashkëta apo të mbështetura nga këta partnerë; garantimi i cilësisë së shërbimit të përkujdesit shoqëror nëpërmjet rishikimit dhe hartimit të standardeve të shërbimeve shoqërore.

### **3.2. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT)**

ISHMT ka si mision garantimin e sigurisë së produkteve për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/përdorim, nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse sipas legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe të të drejtave të tjera sipas fushës së veprimtarisë institucionale.


ISHMT ushtron funksionet e saj në zbatim të VKM-së nr. 36, datë 20.1.2016, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, i ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore dhe nënligjore, duke inspektuar zbatimin e kërkesave të detyrueshme ligjore në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, mbrojtjes së pronësisë industriale, garantimit të mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, të inspektimit metrologjik, të etiketimit për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, si dhe kontrollin e detergjenteve të vendosur në treg.

Trupa inspektuese e ISHMT ka aktualisht në përbërje 50 inspektorë, krahasuar me 60 inspektorë që duhet të ketë sipas strukturës së miratuar, sipas drejtorive: (42) Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve dhe (18) Drejtoria e Pronësisë Intelektuale.


Nga mbikëqyrja rezulton se në periudhën kohore Janar-Dhjetor 2022, ISHMT ka kryer në total 2569 inspektime nga të cilat 2322 inspektime të programuara dhe 247 jashtë programit mbi bazë ankese, sipas drejtorive:

- ✓ Mbikëqyrja e produkteve jo ushqimore – 2095 inspektime, nga të cilat 1921 inspektime të programuara dhe 174 inspektime jashtë programit;
- ✓ Pronësia intelektuale - 457 inspektime, nga të cilat 401 inspektime të programuara dhe 56 inspektime të paprogramuara, mbi bazë ankese.

Grafiku më poshtë, pasqyron inspektimet e realizuara sipas sektorëve të ISHMT-së, inspektimet e programuara në raport me inspektimet jashtë programit.



Trupa inspektuese e ISHMT ka marrë 372 masa administrative në total, nga të cilat 74 “paralajmërimë”, 258 “gjoba” dhe 40 masa urgjente (bllokim, shkatërrim). Janë kontrolluar 11 059 produkte nga të cilat 848 kanë qenë jo në konformitet. Më poshtë, pasqyrohen grafikisht masat administrative (gjobë), sipas sektorëve të ISHMT-së, ku peshën më të madhe e kanë gjobat e sektorit të produkteve elektrike.



Komisioni i Ankimit të Gjobave ka shqyrtuar 158 vendime administrative të ankimuar, nga të cilat:

- ✓ 33 masa administrative “gjobë” janë rrëzuar;
- ✓ 125 masa administrative “gjobë” janë lënë në fuqi.

Në gjykatë janë ankimuar 56 vendime administrative, ku nga këto:

- ✓ 15 çështjeve i është rrëzuar kërkesë-padia nga ana e subjekteve ankimuese;
- ✓ 17 çështjeve u është pranuar kërkesë-padia kundër ISHMT-së;
- ✓ 2 prej tyre janë pranuar pjesërisht;
- ✓ 22 çështje janë në proces gjyqësor.

Për vitin 2022, arkëtimet nga gjobat janë në vlerën prej 15.140.015 lekë.

**Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”:** ISHMT realizon veprimtarinë inspektuese online nëpërmjet pajisjeve portabël laptop dhe jo nëpërmjet tabletave; Veprimtaria inspektuese mbështetet në Programin Vjetor të inspektimeve, për vitin 2022 dhe në Programet Mujore të hartuar me listë subjektsh inspektimi, me fushë veprimtarie të përcaktuar, por jo të hartuar me bazë risku. Konstatohet mospërputhje e subjekteve të programuara për inspektim, sjellë me shkresë dhe dakordësuar nga Inspektoratit Qendror, krahasuar me subjektet e programuara të gjeneruara në sistem. Inspektimet e ushtruara nga ISHMT kryhen me Autorizim, por autorizimi nuk i njoftohet paraprakisht subjektit të inspektimit, përpara fillimit të veprimeve të inspektimit. Mos njoftimi nuk motivohet. Dokumentet Standarde plotësohen në të gjitha fushat e tyre, por ka raste kur nuk detajohen gjetjet, konstatimet apo të pasqyrohen të gjitha veprimet e procedurës inspektuese. Në rastet e inspektimeve të realizuara me laptop, nuk dokumentohet marrja dijeni nga subjekti i inspektimit, i listë-verifikimit dhe procesverbalit të inspektimit apo edhe vendimit përfundimtar. Procedura inspektuese, në shumicën e rasteve, realizohet konform ligjit nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi.

**Arritjet:** Ndikimi në uljen e mos-konformiteteve të produkteve joushqimore si dhe në respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale nëpërmjet inspektimeve të kryera gjatë vitit

2022; Monitorimi dhe inspektimi i subjekteve për zbatimin e çmimit tavan të miratuar nga Bordi i Transparencës; Monitorimi dhe inspektimi i tregut në lidhje me ndalimin e qeseve plastike që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara; Bërja e evidente të ISHMT-së në tregun e produkteve joushqimore dhe në fushën e respektimit të pronësisë intelektuale, si një institucion që ka në fokus kontrollin e respektimit të kriterëve ligjore sipas fushës së veprimtarisë së tij; Informimi i operatorëve ekonomikë, konsumatorëve nëpërmjet përditësimit të vazhdueshëm të informacioneve në web-site: [www.ishmt.gov.al](http://www.ishmt.gov.al), rrjetet sociale, si dhe në median e shkruar dhe elektronike; Informimi i konsumatorëve mbi të drejtat e tyre për të disponuar produkte/pajisje/instalime të sigurta dhe informimin e operatorëve ekonomikë, për të respektuar kërkesat ligjore të përcaktuara në legjislacionin aktual, për të ofruar në treg produkte të sigurta, si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale; Fuqizimi i ISHMT-së dhe rritja e kapaciteteve njerëzore; Kontributi në hartimin e: katër draft VKM, një draft ligj, tre marrëveshje bashkëpunimi, një draft strategji dhe në raportimet për Kapitullin 1, 7 dhe 28 si pjesë e GNP; një rregullore, dy udhëzime dhe dy metodologji.

**Problematikat:** Mungesa e automjeteve të transportit për trupat inspektuese në kryerjen e detyrave funksionale të institucionit, të cilat sjellin vështirësi në realizimin e planit të inspektimeve, duke pasur në konsideratë shtrirjen e gjerë territoriale; Mangësi në vlerësimin e sigurisë së produkteve nëpërmjet aparaturave dhe pajisjeve, e cila lidhet jo vetëm me numrin shumë të kufizuar të këtyre pajisjeve dhe aparaturave, por edhe me mungesën e trajnimeve më të avancuara për përdorimin e tyre; Mungesa e një procedure për produktet që duhet t'i nënshtrohen analizave laboratorike në laboratorë të huaj, duke patur në konsideratë që në Shqipëri ekziston vetëm një laborator i akredituar për analizat e tekstilit dhe lëkurës; Buxheti i limituar i vënë në dispozicion për këtë inspektorat duke pasur në konsideratë gamën e gjerë të produkteve që mbulon për inspektim, si dhe mbulimin e gjerë territorial të vendit; Mungesa e buxhetit për aktivitete sensibilizuese, fletëpalosje, trajnime; Mungesa e përditësimit të adresave të subjekteve në QKB, e cila sjell që shumë inspektime të mos kryhen sepse subjektet nuk gjenden nga inspektorët në adresat që ata kanë deklaruar në QKB.

**Objektivat për vitin 2023:** Kontrolli i respektimit të kriterëve ligjore për grup-produktet që kanë rezultuar me problematika të ndryshme në vitet paraardhëse, produkte për të cilat nuk ka patur veprimtari mbikëqyrëse, si dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale; Realizimi në total i 2 580 inspektime nga të cilat 2 064 të programuara dhe 516 të pa programuara; Informimi i operatorëve ekonomikë për zbatimin e kriterëve ligjore mbi sigurinë e produkteve joushqimore, si dhe mbi respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale; Informimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve mbi sigurinë e produkteve dhe mbi të drejtat e tyre si konsumator; Trajnime të vazhdueshme të stafit për rritjen e shkallës së njohurive në fushat përkatëse; Rritja e bashkëpunimit ndër-institucional dhe atë ndër rajonal në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe të pronësisë intelektuale.

## **4. MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

### **4.1 Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI)**

ISHTI është struktura përgjegjëse për garantimin e përmbushjes së kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike, sigurisë së punës së instalimeve nën presion, sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, si dhe sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë jo ushqimore, duke ushtruar veprimtarinë inspektuese në zbatim të VKM-së nr. 410, datë 13.05.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”.

ISHTI realizon funksionin inspektues nëpërmjet katër drejtorive: Drejtorisë së Inspektimit të naftës e gazit dhe nënprodukteve (DINGN); Drejtorisë së inspektimit të pajisjeve nën presion (DIPNP); Drejtorisë së inspektimit të pajisjeve dhe instalimeve elektrike dhe makinerive ngritëse (DIPIEMN) dhe Drejtorisë së sistemeve të gazifikimit dhe impianteve kombëtare (DSGIK).

ISHTI kryen inspektime në fushat e inspektimit, si më poshtë:

1. Inspektimi i gazit dhe i naftës;
2. Inspektimi i pajisjeve nën presion;
3. Inspektimi i pajisjeve dhe instalimeve elektrike;
4. Transmetim shpërndarje, tregtim, depozitim, ndërtim e operim të infrastrukturës së gazit natyror.


Për vitin 2022, nga mbikëqyrja rezulton se ISHTI, ka planifikuar gjithsej 4985 inspektime dhe ka realizuar gjithsej 5201 inspektime online, prej të cilave 4084 janë të programuara dhe 1117 inspektime jashtë programit, kjo edhe si pasojë e sulmit kibernetik.

Janë vendosur në total 60 masa administrative “gjobë”, ku 3 nga këto janë revokuar me vendim të Komisionit të Ankimit pranë ISHT-it dhe 11 subjekte kanë likuiduar vullnetarisht detyrimin me vlerë 5.425.000 lekë. Janë ankimuar pranë gjykatave administrative të Republikës e Shqipërisë 20 subjekte të ndëshkuara administrativisht nga ISHTI, nga të cilat 4 çështje janë fituar nga ana e ISHTI, 10 çështje janë në proces, si dhe janë pranuar nga Gjykata 6 kërkesë padi.

***Drejtoria e Inspektimit të Naftës Gazit dhe Nënprodukteve (DINGN)*** kryen veprimtari inspektuese në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, duke garantuar kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës dhe gazit, si dhe nënprodukteve të tyre, për t’u siguruar konsumatorëve produkte cilësore.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2022, ka realizuar në total 754 inspektime, prej të cilave 578 inspektime janë të programuara dhe 176 inspektime jashtë programit. Trupa inspektuese e kësaj drejtorie ka vendosur në total 9 masa administrative “gjobë”.

Nga ana e DINGN, janë faturuar 184.329.000 lekë nga kontrolli cilësor në subjektet e tregtimit me shumicë, pakicë dhe parazhdoganimit. Gjatë vitit 2022 kanë ushtuar veprimtari rafineritë e përpunimit të naftës bruto “Al Global Oil” sha UPN, Fier dhe “RBH Beline” sha në Elbasan.



**Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion (DIPNP)** siguron zbatimin e normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve nën presion përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 32, datë 24.03.2016, “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, monitorimin dhe përdorimin e pajisjeve/instalimit nën presion; montimin e pajisjes/instalimit nën presion; pajisja e punonjësve që përdorin pajisje/instalime nën presion me dëshmi aftësie.

Gjatë vitit 2022, ka realizuar në total 2621 inspektime online, prej të cilave 2031 inspektime të programuara dhe 590 inspektime jashtë planit. Janë vendosur 17 masa administrative “gjobë”.

**Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse (DIPIEMN)** siguron zbatimin e normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve elektrike përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar, moszbatimi i procedurave të punimit; ndërhyrje të paligjshme në ambiente elektrike për qëllime të ndryshme; trajtimi i rasteve të aksidenteve.


Gjatë vitit 2022, ka realizuar në total 1821 inspektime online, prej të cilave 1475 inspektime të programuara dhe 346 inspektime jashtë programit, si dhe ka vendosur 34 masa administrative “gjobë”, ku 17 gjoba, janë vendosur në rastet e aksidenteve në punë. Përgjatë këtij viti kanë ndodhur gjithsej 11 aksidente, nga të cilët 8 aksidente janë shoqëruar me



vdekje dhe 3 aksidente me plagosje, të cilat kanë ardhur si rezultat i moszbatimit të procedurave të punimit nga personeli tekniko-profesional elektrik; ndërhyrjes së paligjshme në rrjetin elektrik për qëllime të ndryshme; përdorimi i pajisjeve elektrike të pasigurta në instalime elektrike të pasigurta; kryerja e punimeve në afërsi të linjave elektrike etj.

**Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK)** ka si objekt inspektimin e veprimtarive të gazit nga ana e subjekteve që kryejnë veprimtari gazi, subjekteve të sektorit publik dhe shfrytëzuesve të sistemit të gazit. Objekti i inspektimeve teknike ka të bëjë me aspektet teknike të projektimit, ndërtimit dhe shfrytëzimit të instalimeve dhe pajisjeve që shërbejnë për transmetimin, shpërndarjen, depozitimin nëntokësor të gazit natyror, si dhe terminalet e gazit natyror të lëngëzuar

DSKIG, për vitin 2022, ka kryer 5 inspektime online jashtë planit. Gjithashtu është finalizuar hartimi dhe gjenerimi në sistemin “e-Inspektimi”, i listë-verifikimit “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe është krijuar databazë e operatoreve ekonomik të licencuar nga ERE në fushën e operimit të gazit natyror.



### **Laboratori i Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve**

Drejtoria e Laboratorit Qendror, në aktivitetin e saj, ka si objekt kryerjen me përgjegjësi të analizave laboratorike të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve, si dhe analizave të detergjenteve të ndryshëm, letrës, lëkurës dhe këpucëve në Laboratorin e Tekstilit. Në mënyrë të vazhdueshme ndërmerren aktivitete që përmirësojnë efikasitetin dhe aktivitetin e sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Gjatë vitit 2022, u testuan gjithsej 6410 kampione nga të cilat 2278 kampione të marra në dogana dhe 4 132 kampione të marra për tregun e brendshëm, ku: 999 kampione janë sondazhe, 3 133 kampione janë të plota, 65 kampione janë palë e tretë, ku 21 kampione kanë ardhur të sekretuara nga zyra e protokollit dhe 44 kampione të sekretuara nga zyra e kodifikimit. Nga analizimi 3 kampionë, përkatësisht 3 gazoil, kanë rezultuar me shmangie nga standardi gjatë vitit 2022.



## **Laboratori i Tekstilit**

Gjatë vitit 2022 në Laboratorin e Tekstilit janë kryer analiza dhe janë realizuar disa objektiva si më poshtë:

Implementimi i metodikave të reja si dhe trajnim i personelit me qëllim rritjen e cilësisë në kryerjen e analizave dhe përcaktimeve laboratorike, si dhe futjen e aparaturave të reja bashkëkohore në të ardhmen me qëllim rritjen e numrit të komponentëve të analizuar.

Për këtë periudhë pranë Laboratorit janë kryer kryesisht analiza detergjentesh të ndryshëm, solucione për larje dyshemeje, sapun likuid, larës rrobash, pastrues yndyre, sapun rrobash, zbardhues, etj. Gjithashtu në Laborator janë analizuar për këtë periudhë gjithsej 113 analiza për palët e treta.

**Arritjet:** Nga mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese rezulton se procedura e inspektimit e ndjekur nga ISHTI, kryhet online, me dokumente standarde dhe në përputhje me ligjin për inspektimin dhe ligjet sektoriale; është finalizuar hartimi dhe implementimi në sistemin “e-Inspektimi”, i listë-verifikimit “Për sektorin e gazit natyror”, për DSKIG, si dhe është krijuar data bazë e operatoreve ekonomik të licencuar nga ERE në fushën e operimit të gazit natyror. Laboratori i ISHTI-t, pas marrjes së statusit si “Laborator i Akredituar”, për nxjerrjen e analizave të produkteve të naftës, gazit dhe nënprodukteve të saj, është vlerësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

**Problematikat:** Për sa i përket procesit inspektues online, ISHTI vazhdon të ketë mospërputhje të subjekteve të planifikuara për t’u inspektuar, sipas programeve mujore me subjektet e planifikuara dhe të gjeneruara në sistem për muajt përkatës; për inspektimet e programuara, nuk kryhet njoftimi paraprak i inspektimit; për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore nuk lihen afate kohore, si dhe ka raste të dublimit të gjobës; Dokumentet “Listë-verifikimi” duhet të përditësohen për të treja drejtoritë (DINGN, DIPNP dhe DIPIEMN), pasi janë sipas formatit të vjetër dhe kanë nevojë për përmirësim; nevojat për përmirësimin e kuadrit ligjor lidhur me rregullat e normave teknike për miratimin e standardit të gazit të lëngët dhe sigurinë nga rreziku elektrik; shfuqizimi i Urdhrit nr. 76, datë 18.03.2015, “Për procedurat dhe tarifatat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj” ka sjellë vështirësi për vjeljen e tarifave për kontrollin periodik cilësor të naftës dhe nënprodukteve të saj; vendosja e sistemit të kondicionimit për të ruajtur mostrat në kushte optimale dhe ventilimit anti-zjarr në ambientet e magazinimit të mostrave për largimin e avujve të krijuar nga qëndrimi i mostrave në këto ambiente; trajnimi i inspektorëve, për ngritjen e nivelit profesional në lidhje me veprimtarinë inspektuese të tyre; mungesa e logjistikës (automjete, aparatura, ambiente).

**Objektivat për vitin 2023:** Rritja e nivelit të respektimit të cilësisë sipas standardeve dhe rregullave teknike për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre në tregun e brendshëm, nëpërmjet kontrolleve cilësore të planifikuara; realizimi i kontrolleve për respektimin e kushteve sipas lejeve të marra për të gjitha instalimet për depozitimin e tregtimin e naftës,

gazit dhe nënprodukteve të tyre, me pakicë dhe shumicë, në shoqëritë e pajisura me licencë tregtimi; inspektime për kontrollet cilësore në të gjithë subjektet e tregtimit me shumicë e pakicë, me qëllim që të gjitha produktet që u ofrohen konsumatorëve të jenë konform standardeve të miratuara; vazhdimi i ecurisë së punës për krijimin e bazës së të dhënave për regjistrimin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike; përmirësimi i kuadrit ligjor lidhur me rregullat e normat teknike për miratimin e standardit të gazit të lëngët dhe sigurinë nga rreziku elektrik, si dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

#### **4.2 Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM)**

AKSEM kryen veprimtari në fushën e sigurisë në punë, të emergjencave dhe të shpëtimit në veprimtarinë minerare dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike. AKSEM-i e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror, si person juridik publik, buxhetor. Ky institucion e zhvillon veprimtarinë inspektuese në bazë të ligjit nr. 135/2016, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike” dhe VKM nr. 214, datë 20.04.2018, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera”, si dhe akte të tjera nënligjore në fuqi.


AKSEM, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij, kryen inspektime në veprimtari të minerare dhe ndërtimin e punimeve nëntokësore të veprave energjetike për verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë në punë e mbrojtjen e shëndetit të punonjësve gjatë veprimtarisë së tyre në:

- ✓ Minierat nëntokësore me regjim gazi, të cilat inspektohen jo më pak se 3 (tre) herë në vit;
- ✓ Minierat nëntokësore pa regjim gazi dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, të cilat inspektohen jo më pak se 2 (dy) herë në vit;
- ✓ Minierat sipërfaqësore, fabrikat e pasurimit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve, të cilat inspektohen jo më pak se 1 (një) herë në vit.

AKSEM gjithashtu monitoron e mbikëqyr galeritë e minierave të mbyllura dhe jashtë përdorimi, gatishmërinë e plotë të personelit, pajisjeve dhe mjeteve për të ndërhyrë e përballuar situatën për shpëtimin e njerëzve, vlerëson, mbyll dhe monitoron grykat e punimeve minerare në minierat e braktisura, regjistron çdo subjekt që kryen veprimtari minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike, vlerëson aftësitë teknike dhe profesionale të çdo personi fizik, që kërkon të përdorë e të kryejë punë me lëndë plasëse në subjekte apo të punojë si specialist për emergjencat dhe shpëtim, kryen vlerësimin e projekteve teknike, me qëllim pajisjen e subjekteve me autorizimin e përdorimit civil të lëndëve plasëse, analizon dhe regjistron rastet e emergjencave dhe të aksidenteve të rënda me rrezik apo humbje jete, etj.

Nga mbikëqyrja rezulton se në periudhën kohore Janar-Dhjetor 2022, AKSEM ka kryer në total 455 inspektime nga të cilat 430 inspektime të programuara dhe 25 jashtë programi (5%).

Grafiku më poshtë, pasqyron inspektimet e realizuara sipas sektorëve, inspektimet e programuara në raport me inspektimet jashtë programit.



Trupa inspektuese ka marrë 8 vendime përfundimtare të inspektimit me masë administrative “gjobë”, nga të cilat 2 masa të marra në inspektime të programuara dhe 6 në inspektime jashtë programi, si dhe ndaj 21 subjekteve janë marrë 51 masa administrative kryesore “paralajmërim”.

Komisioni i Ankimit të Gjobave ka shqyrtuar 1 vendim përfundimtarë inspektimi, me masë administrative “gjobë”, të cilin e ka lenë në fuqi.

Për vitin 2022, janë arkëtuar vullnetarisht 5 masa administrative “gjobë” me vlerën 1.300.000 lekë, për 1 masë është lidhur marrëveshje me këste me subjektin dhe 2 të tjera janë në proces.

**Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”:** AKSEM e realizon veprimtarinë inspektuese online nëpërmjet pajisjeve portabël laptop dhe jo nëpërmjet tableteve; Veprimtaria inspektuese mbështetet në Programin Vjetor të Inspektimit për vitin 2022 dhe në programet mujore të hartuar me listë subjektsh inspektimi me bazë rrisht; Inspektimet e ushtruara nga AKSEM kryhen me Autorizim; Dokumentacioni i procedurës së inspektimit plotësohet në të gjitha fushat, por ka raste kur në dosje nuk pasqyrohen të gjitha veprimet e procedurës inspektuese, me dokumentacion bashkëlidhur; Procedura inspektuese, në shumicën e rasteve, realizohet konform ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi.

**Problematikat:** Mungesa e fuqisë punëtore është një problem që konstatohet pothuajse në të gjitha subjektet minerare dhe sa vjen e po bëhet akoma më i mprehtë. Kjo ka sjellë mbylljen e disa subjekteve dhe reduktim të aktivitetit tek pjesa tjetër. Punëmarrësit janë të detyruar të punësojnë punonjës me moshë të madhe dhe pa eksperiencë pune në miniera, gjë që rrit rrisht në punë. Mungesa e drejtuesve teknik është përsëri një problem që po behet akoma më shumë i ndjeshëm. Mungesa e daljes së specialistëve të rinj nga universiteti politeknik, po sjell një perspektivë të zymtë për industrinë minerare në vendin tonë.

**Objektivat për vitin 2023:** si objektiv kryesor mbeten subjektet nëntokësorë me regjim gazi, të cilët vlerësohen subjekte me nivel rrisht të lartë, sidomos subjekti “Albchrome” shpk, i cili

aktualisht ndodhet në një situatë delikate që kërkon monitorim të rreptë të gjendjes së atmosferës minerare për shmangien e ngjarjeve të rënda; subjektet nëntokësore pa regjim gazi, të cilat vlerësohen si subjekte me nivel rrisht të mesëm; subjekte sipërfaqësore, të cilat vlerësohen si subjekte me nivel rrisht të ulët; subjekte të veprave hidro-energjitike, fabrika pasurim; galeritë e mbyllura si dhe inspektimet që mund të dalin jashtë programi si rezultat i revokimit të subjekteve minerare nga ana e ministrisë.

### **4.3 Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor (DIH)**

Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor në zbatim të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, Rregullores nr. 11, datë 17.09.1988, “Për dhënien, heqjen e dëshmisë së aftësisë dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative në hekurudhë”, Rregullores nr. 14, datë 30.09.1988, “Për mirëmbajtjen e vijave hekurudhore”, është autoriteti përgjegjës, që nëpërmjet inspektimit garanton sigurinë në hekurudha.

Aktualisht, DIH është në proces ristrukturimi, referuar ligjit nr. 88/2021, “Për krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore”, si dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 199, datë 16.12.2022, “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës për Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore”.

Nga mbikëqyrja e realizuar online, nëpërmjet portalit unik të inspektimit “*e-Inspektimi*”, rezulton se DIH, për periudhën kohore Janar-Korrik 2022, ka gjeneruar në portal gjithsej 21 inspektime, nga të cilat 18-inspektime janë me statusin mbyllur dhe të programuara, ndërsa 3-inspektime të muajit Korrik janë me statusin të pambyllur për arsyen e sulmit kibernetik. Për vitin 2022 nuk ka asnjë masë administrative.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 nga inspektorët dhe ndihmës inspektorët janë kryer 125 monitorime, të cilat kryesisht në njësitë hekurudhore me rrisht të lartë, duke dhënë rekomandime për përmirësimin e gjendjes së vijës hekurudhore, rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj udhëtarëve, plotësimi me sinjalistikë i kalesave hekurudhore.

**Arritjet:** DIH realizon veprimtarinë inspektuese në përputhje me ligjin për inspektimin, me dokumentacion standard, online, me tabletë nëpërmjet portalit unik të inspektimit “*e-Inspektimi*”; ka pajisur 37 punonjës me dëshmi aftësie, sipas kërkesave të administruesve të Infrastrukturës dhe Ndërmarrjeve hekurudhore.

**Problematikat:** Baza ligjore tek listë-verifikimet e pa përditësuar; mos njoftimi i autorizimit të inspektimit; dokumentacioni i inspektimit nuk plotësohet në të gjitha rubrikat e duhura; niveli profesional i punonjësve nuk është në nivel të kënaqshëm; paga të ulëta; etj.

## 5. **MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

### 5.1. **Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP)**

DPAP është autoriteti përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit, si dhe është pjesë integrale e sistemit të ministrisë përgjegjëse, që kontribuon në realizimin e këtij qëllimi.

DPAP ushtron funksionet e saj mbështetur në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 99, datë 27.02.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhrin nr. 254, datë 30.04.2019, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, si dhe akteve ligjore e nënligjore që i përkasin fushës së arsimit.

DPAP është e përbërë nga një trupë inspektuese prej 22 specialistësh dhe ushtron veprimtarinë e saj në nivel qendror dhe rajonal, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Sektorit të Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë.

Nga mbikëqyrja për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2022, rezulton se DPAP vazhdon të mos jetë përdorues i sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”, pavarësisht se nga ana e Inspektoratit Qendror, është siguruar infrastruktura e duhur për realizimin e procesit inspektues. Janë përshtatur dhe implementuar në sistemin “*e-Inspektimi*”, dokumentet standarde të inspektimit dhe përditësuar listë-verifikimet sipas ndryshimeve ligjore që ka pësuar ligji i tyre sektorial. Gjithashtu është pajisur trupa inspektuese e DPAP me 10 tableta, si dhe është bërë edhe trajnim i trupës inspektuese.

Për vitin 2022, nga DPAP, janë realizuar monitorime/vlerësime sipas planifikimit vjetor dhe të orientuara nga MAS në total 297 monitorime/vlerësime dhe janë propozuar 55 masa, nga të cilat 32 masa disiplinore, si dhe 23 masa administrative.

- ✓ 50 vlerësime në institucione arsimore të arsimit parauniversitar publik;
- ✓ 69 vlerësime në institucione arsimore të arsimit parauniversitar privat;
- ✓ 10 vlerësime në institucione arsimore të arsimit parauniversitar publik/privat bazuar në ankime;
- ✓ 77 vlerësime në zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP);
- ✓ 4 vlerësime në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP);
- ✓ 87 Ankimime.

Janë vendosur 16 dënime administrative kryesore “paralajmërim”, 4 dënime administrative plotësuese “Ndërprerje e menjëhershme e veprimtarisë”, si dhe 3 pezullim licence, për institucionet arsimore jopublike.

**Arritjet:** Gjatë vitit 2022, janë realizuar trajnime në kuadër të programit “Shkollat e Shekullit të 21”, lidhur me aftësitë e drejtuesve të shkollave dhe mësuesve për përdorimin e metodave të mendimit kritik dhe të zgjidhjes problemore dhe teknologjisë në mësimdhënie; Trajnime me Inspektoratin Qendror për portalin unik “*e-Inspektimi*”; trajnime nga ASCAP, si dhe certifikimi i specialistëve të SIVC për programin e trajnimit: “Rrjeti kombëtar i vlerësuesve të institucioneve arsimore parauniversitare”; organizimi i konkursit kombëtar “Gjuha jonë sa e mirë ...!” në bashkëpunim me MAS, i cili vijon dhe për vitin 2023, etj.

**Problematikat:** DPAP, edhe për vitin 2022, nuk realizoi inspektime online, por të gjithë veprimtarinë inspektuese e realizoi me dokumente të parashtypura, pavarësisht se Inspektorati Qendror ka siguruar të gjithë infrastrukturën e duhur.

**Objektivat për vitin 2023:** Vlerësimi dhe inspektimi i zbatimit të kërkesave ligjore nga institucionet arsimore dhe institucionet e varësisë; zgjidhja e ankimeve të ardhura nga nxënës, mësues dhe të tjerë, si dhe marrja e masave nga DPAP; bashkëpunim në vijueshmëri me ASCAP dhe MARS për trajnimin dhe kualifikimin e stafit mësimor apo punonjësve të tjerë jo mësimor; rritja e numrit të monitorimeve dhe vlerësimeve në institucionet arsimore publike dhe private.

## **6. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka në juridiksionin e saj dy inspektorate shtetërore.



### **6.1. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)**

AKU është krijuar bazuar në ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008, “Për Ushqimin”, i ndryshuar dhe filloi funksionimin më 20.05.2010, pra një institucion me një historik aktiviteti relativisht të ri dhe në përpjekje për të realizuar misionin e tij në zbatim të kërkesave ligjore dhe legjislacionit në fuqi. Organizimi dhe funksionimi i institucionit është përcaktuar me VKM nr. 708, datë 9.9.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, e cila shfuqizoi VKM nr. 1081, datë 21.10.2009.

Siguria Ushqimore është parë si një e drejtë themelore njerëzore, detyrim për shtetin. Garantimi i sigurisë ushqimore është një komponent i rëndësishëm i Strategjisë për Sigurinë Kombëtare, përmbushja e të cilit realizohet nëpërmjet qasjes së integruar, që përfshin kontrollin e kultivimit, përpunimit, prodhimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore e blegtorale.

Për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve, duhet siguruar funksionimi efektiv i çdo hallke të zinxhirit ushqimor. Ky princip është i vlefshëm, pavarësisht nga fakti nëse produktet ushqimore prodhohen në Shqipëri apo importohen nga vende të tjera. Një politikë efikase e sigurisë ushqimore duhet të njohë natyrën komplekse të prodhimit të produkteve ushqimore si dhe vlerësimin e monitorimit të risqeve mbi shëndetin e njerëzve.

Nga mbikëqyrja rezulton se AKU në periudhën kohore Janar-Dhjetor 2022, ka kryer në total 23612 inspektime nga të cilat 16846 inspektime të programuara dhe 6766 jashtë programit.



Për periudhën 15 korrik-gusht janë gjeneruar në sistem 632 procedura inspektimi dhe sipas raportimeve të 12 DRAKU-ve, 2009 procedura inspektimi, janë realizuar në formë shkresore. Në regjistrin e gjobave të sistemit “e-Inspektimi” rezultuan 245 çështje inspektimi me Vendim Përfundimtar, masë administrative “gjobë”<sup>3</sup>.

**Arritjet:** Përmirësim infrastrukturor dhe funksional në facilitete PIK & laboratorë; Ngritja e Bordit të Autoritetit Kombëtar; Ngritja e paneleve shkencore me urdhër të Ministrit datë 1.06.2022; Rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional me:

- Inspektoratin Qendror;
- ISUV jo vetëm si laborator;
- Inspektoratin e Shëndetit Publik;
- Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS);
- Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Policisë Kufitare.

<sup>3</sup> Pa patur informacion për masa administrative të mundshme në çështjet e realizuara në formë shkresore.



Fushata digjitale e sigurisë ushqimore, Unifikimi i praktikave të kontrollit zyrtar, Implementim i *Open Balkan initiative*, Transformimi rregullativ institucional, Rekrutimi i stafit dhe trajnime, Digjitalizimi dhe standardizimi i hyrje-daljeve nga Pikat e Inspektimit Kufitar dhe Aplikimi i një metodologjie bashkëkohore të vlerësimit të riskut.

**Objektivat për vitin 2023:** Informatizimi i të gjitha proceseve të punës në AKU, nëpërmjet ngritjes së një sistemi të informatizuar, që siguron automatizimin e terrenit, PIK-ut, laboratorëve dhe prodhimin e raporteve dhe statistikave; Kryerja e inspektimeve online, të inspektimit në pikat e inspektimit kufitar/dogana e brendshme, licencimit, trajtimit të masave administrative, menaxhimit të laboratorëve të analizave, i cili do të ndërthuret me sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe atë të inventarizimit, etiketat, mostrat, etj; Përmirësimi i statistikave dhe raportimeve nëpërmjet standardizimit të raportimeve nga DRAKU, Drejtoritë në AKU qendër dhe rivitalizimit të sistemit AKU net; Ngritja e një rrjeti kosto-efiçent laboratorik të aftë për të garantuar informacion të besueshëm dhe në kohë mbi sigurinë e ushqimeve të tregtuara dhe shëndetin e kafshëve. Rritja e kapaciteteve të rrjetit laboratorik për të kryer monitorime dhe analiza të produkteve ushqimore dhe ushqim për kafshë me referencë specifike në fushat e monitorimit të mbetjeve të pesticideve, diagnozës mikrobiologjike në ushqim dhe ushqim për kafshë, standardeve të cilësisë, sëmundjeve të kafshëve, në përputhje me standarde të përmirësuara; Përmirësim i infrastrukturës në pikat e inspektimit kufitar për poste pune si dhe ambiente për kryerjen e kontrollit fizik për produktet e importit; Krijimi i një road map për fillimin e akreditimit të Laboratorit Fitosanitar Durrës; Përmirësimin dhe plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor me akte nënligjore në përmbushje të nevojave për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me direktivat e Acquis të BE; Trajnimi i plotë i stafit të laboratorëve, shtimi i metodave referuar pajisjeve të reja laboratorike, rritja e efiçencës dhe numrit të analizave pas lëvrimit të pajisjeve laboratorike nga Projekti Safial; Miratimi dhe implementimi i metodologjisë me bazë rrisht për eksportet e MBIB në PIK; Bashkëpunim më i mirë ndër-institucional.

**Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”:** AKU ka Program Vjetor, i cili është sjellë për mendim këshillimor brenda afatit të përcaktuar në Vendimin nr. 696, datë 16.08.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, por hartohet me dy standarde, sipas atij të hartuar nga Inspektorati Qendror si dhe referuar metodologjisë së vlerësimit të riskut të institucionit. Veprimtaria inspektuese është zhvilluar me programe mujore, por për muajin janar plani nuk është paraqitur pranë Inspektoratit Qendror për mendim këshillimor si dhe është hedhur dhe/apo gjeneruar jashtë afateve në sistem si dhe në muajt korrik-gusht për shkak të sulmit kibernetik në muajt nëntor-dhjetor për shkak të deaktivizimit të userave për arsye të pastrimit të tyre dhe të zhvillimit të sistemit nga AKSHI. Disa DRAKU e kanë tejkaluar me mbi 35% përqindjen e inspektimeve jashtë programi, të programuar për vitin 2022. AKU Sektorët UUKOBU dhe MBIB e realizojnë veprimtarinë inspektuese në përputhje me ligjin për inspektimin, me dokumentacion standard, online, nëpërmjet portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”, me program vjetor dhe programe mujore të gjeneruara në portal. AKU Sektori i PIK, nuk kryen inspektime online në sistemin “e-Inspektimi”, në kundërshtim me ligjin nr. 10433/2011, “Për

inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhrin nr. 6, datë 19.02.2015, të Inspektorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”, Urdhrit nr. 7, datë 19.02.2015”, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë për treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit dhe kriteret e vlerësimit e raportimit të tyre”, Urdhrit nr. 25, datë 10.8.2018, “Për miratimin e rregullores, “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, i ndryshuar si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, por vijon me dokumente të parashtypura, me numër serial. Nuk është hartuar nga AKU një procedurë e veçantë për licencimin, e shoqëruar me listë-verifikimet përkatëse, si dhe një procedurë e veçantë për produktet me destinacion asgjësimin.

Një pjesë e veprimtarive inspektuese nuk janë kryer nëpërmjet pajisjes elektronike tabletë. Autorizimi për inspektimin nuk njoftohet paraprakisht për të gjitha procedurat, të cilat kryhen me kërkesë të subjektit, me arsye inspektimi: pajisje me Akt-Miratim Higjieno-Sanitar, asgjësim dhe licencim. Aktet administrative, si kusht për vlefshmërinë ligjore të tyre, nuk nënshkruhen nga trupa inspektuese dhe subjekti/i autorizuar prej tij.

Çështjet në shumë raste nuk përmbajnë të bashkëlidhur dokumentacion justifikues për konstatimet në subjekt *me ose pa* gjetje, realizimin e detyrave të lëna nga inspektimi i mëparshëm, marrjen e njoftimit të procesverbalit, shpjegimet apo kontestimet e subjektit mbi gjetjet e konstatuara në procesverbal (nëse ka), në përputhje me pikën 6, të shtojcës 2, të rregullores nr. 25/2018, të ndryshuar. Vendimi përfundimtar nuk zbatohet konform përcaktimeve ligjore. Nga mbikëqyrja e sistemit, nuk ka informacion mbi ecurinë e masave administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti) nga personi përgjegjës në zbatim të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi” si dhe Rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ”. Në përgjithësi procedura inspektuese, realizohet konform ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi.

**Problematikat:** DRAKU që kanë subjekte të cilat janë të pajisura me numër CE, inspektimet në këto OBU, nuk kryhen nga trupa inspektuese e përcaktuar në urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm dhe për më tepër inspektorët e dytë nuk janë mjek veteriner, gjë e cila mendohet të sjellë penalizim nga auditimet që kryhen nga FVO, pasi kjo trupë inspektuese e përcaktuara në urdhër është përgjegjëse për kontrollin dhe certifikimin e produktit, si një nga kushtet kryesor të eksporteve të produkteve; në disa raste nuk është ndjekur procedura e asgjësimit nga trupat inspektuese; evidentimi i disa mangësive në listë-verifikimet që përdorin trupat inspektuese; mungesë e bazës ligjore për procedurën e licencimit të OB për prodhimin dhe tregtimin e PP me rrezikshmëri; tolerancat e produkteve plehëruese; mungesa e një udhëzuesi/metodologjie për trajtimin komunikimin e rasteve të raport provave të PMB-ve të analizuar nga laboratorit ISUV; mungesa e udhëzimit për asgjësimin e PMB-ve të papërdorshme dhe ambalazheve të tyre, si dhe mungesa e urdhrit për marrjen dhe analizimin

e mostrave të MMSHB për pastërti fitosanitare; kthim përgjigja me vonesë e përgjigjeve të analizimit të mostrave të PMB-ve nga ISUV; mungesa e mjeteve të nevojshme për marrjen, transportimin dhe garantimin e mostrave të inpleteve bujqësore; nevoja për trajnime të inspektorëve të rinj, propozime për disa ndryshime të VKM-së nr. 538, datë 26. 05. 2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, e ndryshuar, janë ende në shqyrtim; mungesa e sistemit i cili do të automatizojë proceset e punës në PIK.

## **6.2.Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakultuës (DSHPA)**

DSHPA zhvillon veprimtarinë inspektuese në bazë të ligjit nr. 64/2012, “Për Peshkimin”, i ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 719, datë 20.10.2011, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit, Sarandë”, i ndryshuar.

Fushat e përgjegjësisë: rregullsinë e veglave të peshkimit të përdorura për llojet, objekt kontrolli, dhe për zëniet e tyre, që janë në bordin e anijes së peshkimit; nëse është e përshtatshme, planin e ngarkesës dhe ngarkesat e veçanta të llojeve; shënjimin e veglave të peshkimit; informacionin përkatës për motorin, ashtu siç parashikohet në ligj; Kontrolli kryhet në ujëra apo në tokë, përfshirë portet, pikat e zbarkimit, mjetet e transportit; qendrat e grumbullimit të peshkut, merkatot, pikat e shitjes dhe restorantet.

DSHPA kryen aktivitetin inspektues në 2 fusha inspektimi, përkatësisht: Peshkim dhe Akuakulturë. Programi vjetor i inspektimit i DSHPA është dërguar për mendim këshillimor pranë Inspektoratit Qendror, brenda afatit ligjor në fuqi, me shkresën nr. 312/1 prot., datë 15.10.2021. Programet mujore paraqiten çdo muaj me subjekte inspektimi dhe NIPT-in përkatës, brenda afatit të përcaktuar ligjor.

DSHPA ka plotësuar modulën e vlerësimit të riskut dhe e ka testuar atë, por nuk e përdor ende.

Aktualisht, DSHPA kryen inspektim me tabletë. DSHPA deri në muajin Shtator 2022, ka kryer 813 inspektime pa tabletë nga 850 (pa tabletë) gjatë të gjithë vitit 2022. Ndërsa inspektimet të kryer me tabletë inspektimi, janë 242 inspektime, në përgjithësi pas shtatorit 2022, pas kërkesave të vazhdueshme nga Inspektorati Qendror.

Për vitin 2022, DSHPA ka kryer gjithsej 1200 inspektime, nga të cilat 847 inspektime të programuara dhe 353 jashtë programit të inspektimit.

## Inspektimet për vitin 2022



Nga Regjistri i gjobave rezulton se për vitin 2022 DSHPA ka vendosur 14 masa administrative “gjobë”, me një vlerë prej 1.402.000 lekë. DSHPA, sipas regjistrimit elektronik të gjobave të sistemit “*e-Inspektimi*”, nuk ka të dhëna në lidhje me masat administrative të apeluar pranë komisionit të apelimit të këtij inspektorati apo ankimet e dërguara në gjykatë nga subjektet e inspektuara. Pra nuk evidentohet ecuria e ankimit administrativ.

**Mbikëqyrja online nga sistemi “*e-Inspektimi*”:** Dokumentacioni i inspektimit nuk plotësohen në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi; Në Autorizimin e inspektimit, nuk jepet baza ligjore e mos njoftimit, megjithëse është detyrim ligjor; Procedura inspektimi që kryhen jashtë orarit të përcaktuar në Autorizim, pa asnjë shpjegim të evidentuar për këtë shkelje procedurale; Në rastet e anulimit të çështjeve të inspektimit nuk jepet, në mënyrë të qartë, arsyeja e anulimit të çështjes; Listë-verifikimet duhet të rishikohen për të qenë në përputhje të plotë me metodologjinë e sistemit “*e-Inspektimi*”; Në procesverbalin e inspektimit nuk përshkruhen me saktësi llojet e gjetjeve të konstatuara, për të argumentuar sa më qartë masën administrative të marrë, si dhe nuk evidentohet objekti i kontrolluar gjatë procedurës inspektuese; Në procedurën e inspektimit, të gjitha faktet dhe shkeljet e konstatuara nuk dokumentohen me dokumentacion të plotë rreth fakteve të mbledhura, (foto, video, dokumente shtesë, etj.) gjë e cila, çon në marrje vendimi përfundimtar të pa argumentuar.

**Arritjet:** Kryerja e inspektimeve me shtrirje gjatë vijës bregdetare ku janë dhe problematikat më të mëdha; Ndërhyrje në liqenin e Ohrit për garantimin e zbatimit të urdhrave të Ministrisë dhe ecurisë së grumbullim-inkubimit e vezëve të Koranit; Grumbullimi i taksës kombëtare brenda afatit të përcaktuar në rregullore; Evidentimi dhe parandalimi i gjuetisë së paligjshme në det; Kontroll në pikat e tregtimit dhe magazinimit të produkteve të pa shoqëruar me certifikatë origjine apo produkteve të ndaluara; Ndërhyrje në liqenin e Shkodrës dhe Ulëz-Shkopetit për garantimin e zbatimit të urdhrave të Ministrisë, si dhe subjekteve për tregtimin e llojeve të ndaluara “Dater”. Si pasojë e këtyre masave të marra është ulur ndjeshëm numri i restoranteve; grumbulluar në masën 98% taksën vjetore të subjekteve që kryejnë aktivitet peshkimi dhe akuakulturë.

**Problematika:** Mungesa të theksuara në pajisje logjistike, pasi vija bregdetare ku janë evidentuar problematikat në fushën e peshkimit është shumë e gjatë dhe në terrene të vështira; Vija bregdetare që i duhet të mbulojë një inspektor arrin deri në 70 km, ku mungesa e logjistikës tokësore dhe asaj ujore është një problematikë e cila kushtëzon kryerjen e

detyrave të inspektorit, për evidentimin dhe parandalimin gjuetisë së paligjshme; Mungesa e dokumentacioneve nga ana e mjeteve të vogla (sanalle) e bën të pamundur aplikimin për pajisje me licencë peshkimi.

**Objektivat për vitin 2023:** Parandalimi dhe evidentimi i gjuetisë së paligjshme; Monitorim i Hapësirës detare nëpërmjet sistemit VMS dhe patrullimit në bashkëpunim; Kontrolle në të gjithë vijën bregdetare për Peshkimin e Paligjshëm Artizanal; Marrja e masave administrative për anijet e peshkimit që do të konstatohen në shkelje; Inspektim në pikat e tregtimit dhe magazinimit të produkteve të pa shoqëruar me certifikatë origjine apo produkteve të ndaluara; Ndërhyrje në liqenin e Ohrit për garantimin e grumbullim-inkubimin e vezëve të Koranit; Ndërhyrje në liqenin e Shkodrës dhe Ulëz-Shkopetit për zbatimin e urdhrave të Ministrit; Grumbullimi i taksës kombëtare brenda afatit të përcaktuar në rregullore.

## **7. MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

### **7.1. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH)**

ISHSH ka si mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik. ISHSH-ja është përgjegjëse për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike.

ISHSH është institucion qendror, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.


Në zbatim të VKM nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, ISHSH në nivel qendror planifikon dhe bashkërendon veprimtarinë e inspektimit; siguron unifikimin e praktikave të inspektimit, në shkallë vendi; bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve dhe siguron kryerjen e analizave nga laboratorë të akredituar; informon publikun për veprimtarinë e inspektimit; jep mbështetje teknike dhe administrative për veprimtarinë e inspektimit; përgatit programin dhe raportin vjetor të inspektimit, si dhe kryen drejtpërdrejt inspektime ndaj subjekteve të mëdha të inspektimit që kryejnë veprimtari me rrezik të lartë. Degët rajonale të ISHSH-së ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut përkatës dhe janë përgjegjëse për inspektimin.

Trupa inspektuese e ISHSH ka aktualisht në përbërje rreth 227 inspektorë në total.

Nga mbikëqyrja rezulton se në periudhën kohore Janar-Dhjetor 2022, ISHSH në total ka realizuar 21173 inspektime, nga të cilat 18329 të programuara dhe 2844 jashtë programi (13.43 %).


Grafiku më poshtë, pasqyron inspektimet e realizuara sipas fushave të ISHSH, inspektimet e programuara në raport me inspektimet jashtë programit.

## INSPEKTIVE SIPAS FUSHËS SË INSPEKTIMIT



Trupat inspektuese kanë marrë 294 Vendime Përfundimtare Inspektimi me masë administrative gjobë dhe në 1 446 subjekte kanë marrë dënim kryesorë paralajmërim. Më poshtë, pasqyrohen grafikisht masat administrative (gjobë), sipas qarqeve, të marra në inspektive të programuara dhe jashtë programi.

## Masa Administrative Gjobe 2022



	Tiranë	Durrës	Berat	Elbasan	Dibër	Fier	Vlorë	Gjirokastrë	Shkodër	Lezhë	Kukës	Korçë	Drejtoria Përgjithshme
Totali	132	47	8	17	6	4	12	13	18	11	8	14	4
Programuae	28	3	2	13	1	1	0	1	4	2	0	0	0
Jashtë programi	104	44	6	4	5	3	12	12	14	9	8	14	4

Komisioni i Ankimit të Gjobave ka shqyrtuar 175 vendime administrative të ankimuar, nga të cilat:

Janë shqyrtuar 175 masa administrative, ku nga këto:

- ✓ 10 masa administrative (gjobë) janë rrëzuar;
- ✓ 165 masa administrative (gjobë) janë lënë në fuqi.

Në gjykatë janë zhvilluar 162 procese gjyqësore, gjatë vitit 2022, ku nga këto:

- ✓ 55 procese gjyqësore të fituara;



- ✓ 43 procese gjyqësore të humbura;
- ✓ 65 procese gjyqësore në procedurë;
- ✓ 18 procese gjyqësore në procedurë Apeli Administrativ.

Për vitin 2022, ka në total 68 masa të ekzekutuara me vlerë 32.724.681 Lekë, nga të cilat 50 janë bërë në mënyrë vullnetare, 11 masa administrative janë dërguar nga ISHSH me Vendim Urdhër Ekzekutimi dhe 71 masa administrative me Vendim Lëshim Urdhër Ekzekutimi janë në procedurë.

**Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”:** ISHSH e realizon veprimtarinë inspektuese online nëpërmjet tabletës por 34.63 % të inspektimeve i ka realizuar nëpërmjet web-it. Veprimtaria inspektuese mbështetet në Programin Vjetor të inspektimeve, për vitin 2022 dhe në Programet Mujore të hartuar me listë subjektsh inspektimi, të hartuara me bazë risku. Inspektimet e ushtruara nga ISHSH kryen me Autorizim, por nuk dokumentohet gjithmonë, njoftimi paraprak i autorizimit. Në rastet kur inspektimi realizohet pa njoftim paraprak, nuk dokumentohet njoftimi përpara fillimit të veprimeve të inspektimit dhe mos njoftimi nuk motivohet. Kur inspektimi realizohet jashtë programi nuk ndodhet bashkëlidhur dokumentacioni për realizimin e kësaj procedure. Në shumë raste, në autorizim nuk përcaktohet saktë objekti i inspektimit. Dokumentet standarde plotësohen, përgjithësisht, në të gjitha fushat e tyre, por ka raste kur ka mangësi dhe nuk detajohen gjetjet, konstatimet apo nuk pasqyrohen të gjitha veprimet e procedurës inspektuese. Ka raste kur dokumentacioni nuk plotësohet pranë subjektit dhe ka mospërputhje midis kohëzgjatjes së deklaruar të inspektimit në procesverbal dhe kohëzgjatjes së mbajtjes së dokumentacionit në sistem. Në rastet kur dokumentacioni nuk nënshkruhet nga subjekti i inspektimit, nuk dokumentohet gjithmonë marrja dijeni për procedurën e inspektimit të mbajtur. Procedura inspektuese, në shumicën e rasteve, realizohet konform ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi.

**Arritjet:** Puna dhe aktiviteti i ISHSH gjatë vitit 2022 janë kryer bazuar në përvojën më të mirë dhe duke pasur në synim funksionimin e një institucioni që i përgjigjet kërkesave për mbrojtjen e shëndetit të popullatës. Përveç detyrave funksionale, trupa inspektuese e ISHSH ka kryer kontrole të vazhdueshme për zbatimin e protokolleve të masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19; Evidentimi i kushteve higjieno-sanitare dhe zbatueshmëria e rregulloreve të MSHMS në funksion të evidentimit të plotësimit të standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit në shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor publik, për specialitetet që ofrohen në shërbimin spitalor në kuadër të Reformës së Autonomisë Spitalore; Për sigurimin e kushteve optimale të mësimin dhe jetesës në institucionet arsimore parashkollore, shkollore dhe universitare në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; Sigurimi i një sezoni turistik të sigurtë dhe të shëndetshëm; Evidentimi i derdhjeve të ujërave të zeza në zonat turistike dhe kushteve higjieno-sanitare të subjekteve akomoduese dhe restaurantet, me qëllim shmangien e ngjarjeve të padëshiruara në shëndetin e popullatës; Inspektimi i subjekteve të furnizimit me ujë të pijshëm duke minimizuar shpërthimet e sëmundjeve infektive me origjinë hidrike; Bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Policinë e Shtetit për ndalimin e tregtimit të ujit në mënyrë të paligjshme dhe në kushte jo të mira higjieno-sanitare; Përgjigja në kohë reale për të gjitha

lajmërimet e kryera nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, për persona pozitivë për COVID-19, duke mbyllur çdo ambient apo subjekt, për të parandaluar përhapjen e infeksionit.

**Problematikat:** Mungesa e automjeteve të transportit për trupat inspektuese në kryerjen e detyrave funksionale të institucionit, të cilat sjellin vështirësi në realizimin e procedurës inspektuese brenda kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizim; Mungesa e përditësimit të adresave të subjekteve në QKB, e cila sjell që shumë inspektime të mos kryhen sepse subjektet nuk gjenden nga inspektorët në adresat, që ata kanë deklaruar në QKB.

**Objektivat për vitin 2023:** Inspektimet për plotësimin e standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit për specialitetet që ofrohen në shërbimin spitalor; Inspektime për plotësimin e standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit për specialitetet që ofrohen në shërbimin parësor; Inspektime para dhe gjatë sezonit turistik veror me qëllim krijimin e kushteve optimale për një sezon turistik veror të sigurt dhe parandalimin e rasteve të intoksikacioneve apo përhapjen e sëmundjeve infektive; Krijimi i një sistemi mbarëkombëtar gjurmueshmërie të kripës për konsum njerëzor, shtazor dhe përdorim në industrinë ushqimore; Inspektime për evidentimin e kushteve higjieno-sanitare në subjekte publike dhe jopublike arsimore; Inspektime në subjektet e furnizimit me ujë të pijshëm bazuar në vlerësimin e riskut; Ndryshime dhe përgatitje rregulloresh të veçanta në kuadër të përputhshmërisë së legjislacionit vendas me BE; Inspektime për monitorimin e zbatimit të ligjeve të veçanta, kompetencë e ISHSH si ligji për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, ligji për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji, ligji për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut, ligji për produktet kozmetike, ligji për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, etj.

## **7.2. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM)**

AKBPM, është një institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e specializuar për analizën dhe kontrollin e barnave, për dhënien e autorizimit për tregtim, për inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike, për farmakovigjilencën dhe për administrimin e standardeve të pajisjeve mjekësore.

Ndër funksionet e AKBPM është inspektimi i barnave pranë subjekteve farmaceutike, të cilat kanë të bëjnë me vendosjen në treg, tregtimin me shumicë dhe pakicë, kushtet e ruajtjes së barnave, lëndëve të para dhe ndihmëse e materialeve ambalazhuese, tregtimin dhe eksportimin e barnave të prodhuara nga fabrikuesit vendas, importin e barnave, autorizimin për import, si dhe pajisjeve mjekësore. Ky institucion e ushtron veprimtarinë inspektuese në zbatim të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, ligjit nr. 89/2014, “Për Pajisjet Mjekësore”, i ndryshuar, VKM nr. 24, datë 14.1.2015 “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të agjencisë kombëtare të barnave dhe pajisjeve mjekësore”, e ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.

Në zbatim të VKM nr. 24, datë 14.1.2015 “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të agjencisë kombëtare të barnave dhe pajisjeve mjekësore”, i




ndryshuar, AKBPM ka gjithsej 99 punonjës. Sektori i inspektimit ka 21 punonjës nga të cilët 20 inspektorë dhe 1 shef sektori, përgjegjës për inspektimin në fushën farmaceutike për barna dhe pajisje mjekësore.

Nga mbikëqyrja e realizuar online, nëpërmjet portalit të inspektimit “*e-Inspektimi*”, rezulton se AKBPM, gjatë vitit 2022, ka programuar 1291 inspektime dhe ka realizuar 1033 inspektime, nga të cilat 667 janë të programuara dhe 366 jashtë programi (35.43 %), si dhe janë marrë 46 Vendime Përfundimtare Inspektimi me masë administrative gjobë, nga të cilat 18 janë marrë në inspektime të programuara dhe 28 në inspektime jashtë programi (60 %).

Në portalin unik të inspektimit nuk ka informacion mbi komisionin e ankimimit, nëse ka pas ankime administrative, sa janë lënë në fuqi dhe sa janë shfuqizuar, si dhe për shqyrtimet në gjykatë.

Grafiku më poshtë, pasqyron inspektimet e realizuara sipas sektorëve të AKBPM-së, duke pasqyruar edhe numrin e inspektimeve të programuara në raport me inspektimet jashtë programi, për çdo fushë.



*Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”*: AKBPM, realizon procesin inspektues online nëpërmjet pajisjeve tabletë. Veprimtaria inspektuese mbështetet në Programin Vjetor të Inspektimit për vitin 2022 dhe në programet mujore të hartuar me listë subjektsh inspektimi me bazë risku por ka shumë raste ku programi mujor i miratuar në formë shkresore nuk gjenerohet i plotë në portalin unik të inspektimit “*e-Inspektimi*” dhe brenda afateve të përcaktuara. Inspektimet e ushtruara nga AKBPM kryen me Autorizim. Dokumentacioni i procedurës së inspektimit plotësohen në të gjitha fushat, por ka raste kur në dosje nuk pasqyrohen të gjitha veprimet e procedurës inspektuese, me dokumentacion bashkëlidhur. Procedura inspektuese, në shumicën e rasteve, realizohet konform ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi.

AKBPM, nuk ka sjellë raportin vjetor të inspektimit për vitin 2022.

### 7.3. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR)

ZMR zhvillon veprimtarinë inspektuese në 2 fusha inspektimi, për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, sipas ligjit nr. 8025, datë 09.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar, ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, i ndryshuar, si dhe akte të tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e saj.

ZMR, në fushën e rrezatimit jonizues, kryen funksione inspektuese ndaj të gjitha subjekteve shtetërore dhe private, që kryejnë veprimtari me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese, me qëllim mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rreziqeve, të popullatës dhe mjedisit, në tërësi, nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve, si dhe sigurimin e materialeve radioaktive.

Gjatë vitit 2022, ZMR ka realizuar inspektime në kabinetet e radiologjisë shtetërore dhe private që kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X, në qendra ku aplikohet veprimtari me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive, si dhe matje në lidhje me fuqinë e dozës, në ambientet publike dhe në ato ambiente ku stafi është i angazhuar në punë me burime të rrezatimit jonizues.


ZMR, për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2022, ka realizuar gjithsej 82 inspektime online, prej të cilave 76 inspektime të programuara dhe 6 inspektime jashtë planit.



Janë marrë 55 masa administrative kryesore, si më poshtë:

- ✓ 47 dënim administrativ kryesor “Paralajmërim”;
- ✓ 3 Dënim administrativ kryesor “Heqje licencë”;
- ✓ 5 Dënim administrativ kryesor “Gjobë”.

## Masat Administrative për vitin 2022, krahasuar me vitin 2021



Nuk është ankimuar asnjë nga masat administrative që kanë marrë inspektorët e ZMR- së.

**Arritjet:** Nga mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese, rezulton se ZMR realizon veprimtarinë inspektuese 100 % online, me tablet (mobile), me dokumente standarde, në përputhje të plotë me ligjin për inspektimin dhe ligjin për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese; realizon njoftimin paraprak të subjekteve që do të inspektohen brenda afateve të përcaktuara me ligj, si dhe ky njoftim bashkëlidhet në sistemin “*e-Inspektimi*”.

**Problematikat:** ZMR vazhdon të mos kryejë inspektime për sa i përket zbatimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi jojonizues, mangësi e konstatuar edhe në raportet e mbikëqyrjes së viteve të mëparshme, kjo për arsye të mungesës së pajisjeve për kryerjen e matjeve të rrezatimit jojonizues, si dhe akoma nuk është finalizuar hartimi i listë-verifikimit për fushën e rrezatimeve jojonizuese.

**Objektivat për vitin 2023:** Ka planifikuar kryerjen e inspektimeve në 99 subjekte private dhe shtetërore në të gjithë vendin, ku të gjitha inspektimet do të vazhdojnë të kryhen online dhe me tableta, sipas ligjit për inspektimin; fillimi i inspektimeve të burimeve të rrezatimit jojonizues, rishikimi i listë-verifikimeve me qëllim përmirësimin e tyre dhe reflektimin e kërkesave të reja.

## 8 MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

### 8.1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)


Agjencia Kombëtare e Mjedisit ushtron inspektime duke synuar ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, si dhe përdorimin e matur dhe racional të natyrës e të burimeve të saj në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

AKM ushtron funksionet e saj në zbatim të VKM-së nr. 568, datë 17.07.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, i ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore dhe nënligjore. AKM-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në 2 nivele: nivel qendror, përmes Drejtorisë së Përgjithshme dhe nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) Agjencive Rajonale të Mjedisit (ARM).


Trupa inspektuese e AKM-së ka në përbërje 101 inspektorë, në nivel qendror 25 inspektorë, ARM Tiranë 25 inspektorë, ARM Berat 20 inspektorë, ARM Fier 18 inspektorë dhe ARM Lezhë 13 inspektorë .

AKM, për periudhën Janar-Maj 2022, nuk ka ushtruar aktivitet inspektues, por prioritet i punës kanë qënë ankesat e ardhura nga qytetarët nëpërmjet portalit të Bashkëqeverisjes dhe atyre në rrugë zyrtare pranë AKM, duke shqyrtuar dhe dhënë zgjidhje të gjitha ankesave sipas rasteve, në një numër total prej 148 ankesave, në fushën e ujërave dhe mjedisit.

Nga mbikëqyrja rezulton se gjatë periudhës Qershor-Dhjetor 2022, AKM ka realizuar 1215 inspektime gjithsej, ku 228 inspektime të programuara dhe 987 jashtë programit. Grafiku në vijim, paraqet inspektimet e realizuara sipas rajoneve dhe fushave të inspektimit.



Trupa inspektuese, gjatë vitit 2022, ka marrë 112 masa administrative, nga të cilat 77 gjoba, 22 paralajmërime dhe 13 pezullime. Vlera në lekë e të gjitha masave të vendosura është 30 320.000 Lekë. Grafiku më poshtë pasqyron masat administrative të marra sipas rajoneve të AKM-së.



Për vitin 2022, pranë Komisionit të Ankimit në AKM janë depozituar dhe shqyrtuar 72 ankime administrative, nga të cilat:

- ✓ 25 masa administrative (gjobë) janë rrëzuar;
- ✓ 41 masa administrative (gjobë) janë lënë në fuqi;
- ✓ 2 masa administrative (gjobë) janë ndryshuar;
- ✓ 2 ankime nuk janë pranuar për shqyrtim, për shkak të kalimit të afatit procedural për paraqitjen e ankimit administrativ.

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, 4 masa administrative janë në proces shqyrtimi për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit dhe 16 masa administrative janë ekzekutuar tërësisht.

**Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”:** Procedura inspektuese, përgjithësisht, realizohet konform ligjit nr. 10433/2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi; AKM realizon veprimtarinë inspektuese nëpërmjet pajisjes portabël laptop, në bazë të Programit Vjetor të inspektimeve për vitin 2022, të hartuar në bazë të prioriteteve dhe objektivave, për fushën e mjedisit dhe ujërave të miratuar nga autoriteti përgjegjës. Gjatë periudhës Qershor-Dhjetor 2022, inspektimet realizohen sipas Programeve Mujore të dakordësuara nga IQ, por jo nga të gjitha rajonet e AKM-së; Inspektimet e ushtruara nga AKM, përgjithësisht, janë kryer me Autorizim dhe me njoftim paraprak të autorizimit subjektiv të inspektimit; Dokumentet standarde të inspektimit, në përgjithësi, plotësohen në tërësinë e tyre dhe në mënyrë të saktë; Lidhur me dënimin apo masën që duhet marrë inspektori, në përputhje me rëndësinë e shkeljeve apo pasojave të tyre është e nevojshme hartimi i rregullores për metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative; Dokumentet e veprimtarisë inspektuese të gjeneruara në sistem nuk janë të nënshkruara nga kryeinspektori, inspektorët apo subjekti i inspektimit, pasi inspektimet nuk janë realizuar me tabletë.

**Arritjet:** Kryerja në mënyrë më efektive e procesit të inspektimit nëpërmjet sistemin online “e-Inspektimi”; Menaxhimi dhe raportimi elektronik, sipas portalit “e-Inspektimi” duke përmirësuar përputhjen me procedurat e dokumentuara të inspektimit; Informatizimi i

ndjekjes së problematikës sipas sistemit unik “*e-Inspektimi*”; Përfshirja në një Task Forcë Rajonale fokusuar në gjetjen e subjekteve me pa përputhshmëri; Krijimi i një lidhje telefonike për raportimin e parregullsisë, të mashtrimit dhe incidenteve; Krijimi i një zyre të trajnimit për të rritur kapacitetet e inspektorëve, si dhe për të lehtësuar punën e tyre me trajnimet; Inicimi për krijimin e një programi të trajnimit profesional për inspektorë të punësuar rishtas; Reduktimi i ndjeshëm i ditëve të inspektimit, si pasojë e planifikimit të inspektimeve mbi bazë risku.

**Problematikat:** Baza e të dhënave jo e përditësuar e subjekteve të pajisura me leje mjedisore; Verifikimi i subjekteve të inspektuara për t’u pajisur me leje mjedisore, si dhe përmirësimin e mjedisit; Ndjekja e ankesave të ardhura nga Zyra e Bashkëqeverisjes me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe sigurimin e jetesës së njeriut, si dhe kthimin e përgjigjeve brenda afateve; Mungesa e zyrave për inspektorët; Mungesë e bazës materiale (kompjuter, tablet, skaner, fotokopje); Mungesë e logjistikës (automjete); Mungesa e një regjistri elektronik të subjekteve aktive të pajisura me Leje Mjedisore; Nevoja për përmirësim të listë-verifikimit në fushën e mjedisit; Nevoja për trajnim i inspektorëve të rinj për sistemin online “*e-Inspektimi*”.

**Objektivat për vitin 2023:** Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me procesin e VNM-ve; Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji; Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit; Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike; Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj; Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror; Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit; Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut; Ndërgjegjësimi i publikut në vendimmarrjen mjedisore; Thjeshtimi i procedurave për biznesin; Thjeshtimi i procedurave dhe shkurtimi i afateve për shqyrtimin dhe dhënien e vendimit; Krijimi i një baze të dhënash (regjister elektronik) për të gjitha procedurat e kryera dhe dhëniet e vendimeve përkatëse.

## **8.2. Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB)**

AKB synon zbatimin e kriterëve dhe të kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke inspektuar mjediset dhe dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike, si dhe duke monitoruar rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare, në kuadër të respektimit të rregullave për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare.

AKB ushtron funksionet e saj në zbatim të VKM-së nr. 568, datë 17.07.2019, “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, i ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore dhe nënligjore, në territoret, objektet e veprimtaritë që ndodhen ose zhvillohen, tërësisht ose pjesërisht, apo kanë ndikim në zonën bregdetare në Republikën e Shqipërisë.

Trupa inspektuese e AKB-së, në nivel qendror ka në përbërje 17 inspektorë, ndërsa në 4 (katër) rajonet ka nga 1 (një) specialist, të cilët nuk kryejnë inspektime.


Nga mbikëqyrja rezulton se në periudhën kohore Janar-Dhjetor 2022, AKB, Drejtoria Qendrore ka realizuar 798 inspektime gjithsej, ku prej të cilave:

- ✓ 248 inspektime për pajisjen me certifikatë kategorizimi të strukturave akomoduese dhe zbatimi i kriterëve dhe kushteve minimale sipas kategorisë;
- ✓ 109 inspektime në agjenci udhëtimi dhe operatorë turistikë me licencën përkatëse;
- ✓ 427 inspektime për stacionet e plazhit;
- ✓ 14 inspektime të veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik.

Gjithashtu, AKB-DQ ka kryer 537 kontrolle me karakter monitorues në strukturat akomoduese dhe stacionet e plazhit.

Trupa inspektuese, gjatë vitit 2022, ka marrë gjithsej 219 masa administrative, nga të cilat 91 gjoba dhe 128 paralajmërimë. Vlera në lekë masave administrative, gjobë të vendosura është 13.040.000 Lekë.

Grafiku në vijim, paraqet inspektimet e realizuara gjatë vitit 2022, sipas fushës së veprimtarisë dhe masat administrative përkatëse të marra nga trupa inspektuese e AKB-së.



Për vitin 2022, pranë Komisionit të Ankimit në AKB janë depozituar 43 ankime dhe shqyrtuar 32 ankime administrative, nga të cilat:

- ✓ 3 masa administrative (gjobë) janë rrëzuar;
- ✓ 29 masa administrative (gjobë) janë lënë në fuqi.

Nga masat administrative të lëna në fuqi nga Komisioni i Ankimit, 2 (dy) vendime administrative janë ankimuar pranë gjykatës, ku janë lënë në fuqi masat administrative.



**Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”:** AKB realizon veprimtarinë inspektuese nëpërmjet pajisjes portabël tablet, në bazë të Programit Vjetor të Inspektimeve, të hartuar në bazë të prioriteteve dhe objektivave, dakordësuar nga Inspektorati Qendror dhe të miratuar nga autoriteti përgjegjës. Veprimtaria inspektuese mujore mbështetet në Programet Mujore, të hartuar me listë subjektsh inspektimi, me fushë veprimtarie të përcaktuar dhe hartuar me bazë risku, por jo për çdo muaj. Inspektimet e ushtruara nga AKB kryen me Autorizim dhe me njoftim. Dokumentet standarde të inspektimit plotësohen në tërësinë e tyre dhe kryesisht në mënyrë të saktë. Procedura inspektuese realizohet konform ligjit nr. 10433/2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi.

**Arritjet:** Ndikimi në rritjen e zbatueshmërisë së kriterëve ligjore gjatë ushtrimit të aktivitetit të operatorëve ekonomikë që ushtrojnë veprimtari turistike si stacionet e plazhit, nëpërmjet inspektimeve e monitorimeve të kryera gjatë vitit 2022; Bërja e evidentave të inspektoratit të turizmit në sektorin e hotelerisë (strukturave akomoduese) si rezultat i inspektimeve për përmbushjen e kriterëve të detyrueshme për secilën kategori, duke përmirësuar rritjen e standardeve për këtë sektor të rëndësishëm; Ndikimi në rritjen e numrit të subjekteve të licencuara me aktivitet agjenci udhëtimi, operatorë turistikë dhe udhërrëfyes turistikë duke ulur shkallën e informalitetit në këtë sektor, nëpërmjet inspektimeve të programuara në bazë të analizës së riskut.

**Problematikat:** Nevoja e përcaktimit të qartë të kompetencave për zbatimin e akteve ligjore, lidhur me VKM nr. 845/2020 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi”, në mënyrë që të inspektohet zbatueshmëria e kërkesave ligjore; Vështirësitë e subjekteve në përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga ligjet dhe aktet nënligjore të miratuara sipas fushave specifike, si pasojë e mos njohjes së mjaftueshme të këtyre detyrimeve.

**Objektivat për vitin 2023:** Kryerja e inspektimeve për kontrollin e kriterëve ligjore nga subjektet në lidhje me fushat që janë në fokusin e punës së AKB-së; Mbarëvajtja e sezonit turistik nëpërmjet kontrollit të zbatimit të kushteve dhe kriterëve në stacionet e plazhit dhe aktivitetet e turizmit detar, përgjatë gjithë zonave bregujore; Hartimi i listë-verifikimeve për aktivitetet e turizmit detar në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për këto veprimtari turistike; Hartimi i metodologjisë së riskut për subjektet që veprojnë në fushën e agjencive dhe operatorëve turistikë, strukturave akomoduese, udhërrëfyesve turistikë, stacioneve të plazhit dhe operatorëve të turizmit detar, duke u nisur nga rezultatet e inspektimeve të mëparshme dhe përfshirja e tyre në planin e punës për 2023.

## VII. Raportimi i veprimtarisë për inspektoratet vendore

Përgjatë vitit 2022, Inspektorati Qendror në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligji i qeverisjes vendore nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore”, i ndryshuar, ka vazhduar punën me qëllim që 42 njësi të qeverisjes vendore të bëhen pjesë e sistemit “e-Inspektimi”.

Për këtë qëllim, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore mbi funksionet e inspektimit që mbulon secila bashki, janë hartuar listat e verifikimit dhe përshtatur dokumente standarde të inspektimit, të cilat tashmë janë implementuar në sistemin “e-Inspektimi”.

Gjithashtu, Inspektorati Qendror, në zbatim të nenit 16, të ligjit për inspektimin mban dhe përditëson Regjistrin e Inspektorëve shtetërorë/vendorë në detyrë dhe për këtë vit që kaloi njësitë e qeverisjes vendore nuk dhanë informacion lidhur me lëvizjet e burimeve njerëzore në fushat e inspektimit që mbulon secila bashki.

## VIII. Raport Monitorimi i Buxhetit për vitin 2022 për Inspektoratin Qendror

Në zbatim të ligjit nr. 115/2021 “Për Buxhetin e Vitit 2022”, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Inspektoratit Qendror i është miratuar plani i buxhetit prej **42.000.000 lekë**, por me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është ndryshuar plani i buxhetit, dhe konkretisht pakësohet, llog. 600 (paga) pakësohet në vlerën 600 000 lekë, llog. 601 (sig. Shoq. Punëdhënës) pakësohet në vlerën 102500 lekë, llog. 602 (shpenzime operative) pakësohet 1 080 000 lekë, dhe me VKM nr. 898, datë 29.12.2022 shtohet llog. 606 (ndihma ekonomike) në vlerën 220 000 lekë, dhe plani i rishikuar i buxhetit për vitin 2022 detajohet si më poshtë:

Në /lekë

Llog.ekonomike	Përshkrimi	Plan 2022	Plan i ndryshuar 2022
llog. 600	Paga	24 000 000	23 400 000
llog. 601	Sig. shoq punëdhënës	4 100 000	3 997 500
llog. 602	Shpenzime operative	10 800 000	9 720 000
llog. 606	Ndihma ekonomike	100 000	320 000
llog. 231	Shpenzime kapitale	3 000 000	3 000 000
	<b>TOTALI</b>	<b>42 000 000</b>	<b>40 437 500</b>

Për vitin 2022, IQ ka realizuar buxhetin në vlerën 37.775.733 lekë nga totali i akorduar prej 40.437.500 lekë ose 93.42 % të fondit të planifikuar vjetor 2022. Diferenca e fondit të planifikuar me fondin e realizuar është sipas tabelës më poshtë:

*Në /lekë*

Llog.ekonomike	Përshkrimi	Buxheti Vjetor Plan i Viti 2022	Fakti i vitit progresiv 2022	Realizimi buxhetor 2022 në %
Ilog. 600	Paga	23 400 000	22 053 259	94.24%
Ilog. 601	Sig. shoq punëdhënës	3 997 500	3 697 864	92.50%
Ilog. 602	Shpenzime operative	9 720 000	8 725 223	89.76%
Ilog. 606	Ndihma ekonomike	320 000	310 817	97.19%
Ilog. 231	Shpenzime kapitale	3 000 000	2 988 600	99.63%
	<b>TOTALI</b>	<b>40 437 500</b>	<b>37 775 733</b>	<b>93.42%</b>

**Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore** (zëri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me VKM nr. 24, datë 03.03.2017, me 21 punonjës.

Për vitin 2022 deri tani, numri i punonjësve është 18 punonjës faktik, sipas strukturës.

**Fondi per shpenzime kapitale** (zëri 231) , me financim të brendshëm.

Për vitin 2022, plani i buxhetit për shpenzime kapitale me financim të brendshëm është akorduar në vlerën 3.000.000 lekë (zëri 231), lekë kapitale të trupëzuara dhe u realizua 99.63% për blerje pajisje hardware për inspektime online për inspektoratet shtetërore. Ky fond ishte akorduar për “Blerje Tableta dhe zhvillimi i tyre në sistem”, që u prokuruan nga AKSHI, sipas specifikimeve të publikuara dhe miratuara, dhe u realizuan me sukses.

Në realizimin e zërave buxhetore të planifikuar për Vitin 2022, Inspektorati Qendror ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 10433 datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe legjislacionin administrativo-financiar shqiptar të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”.

## IX. KONKLUZIONE

Inspektorati Qendror, bazuar në arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin 2022 dhe në analizën në tërësi të komponentëve të veprimtarisë inspektuese, konkludon se procesi inspektues ka përmirësime që lidhen kryesisht me kryerjen e inspektimeve online, me dokumente të standardizuara, pranë dhe në prani të biznesit, duke rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë në marrjen e vendimeve, si dhe duke ulur barrën administrative ndaj biznesit.

Për sa më sipër në këtë raport konkludojmë se:

- ✓ 14 inspektorate shtetërore/trupa të tjera inspektuese realizojnë veprimtarinë inspektuese online nëpërmjet portalit unik “*e-Inspektimi*”, sipas ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 696/2013, ligjeve sektoriale, si dhe akteve të tjera dhe nënligjore në fuqi.
- ✓ Procesi inspektues në disa prej inspektorateve shtetërore apo drejtorive rajonale realizohet nëpërmjet kiteve portabël dhe jo tabletave, gjë e cila e bën të pamundur verifikimin nëse dokumentacioni inspektues është mbajtur pranë dhe në prani të subjektit të inspektimit, në zbatim të pikës 2, të nenit 45, të ligjit për inspektimin.
- ✓ 42 njësi të qeverisjes vendore janë të implementuara (dokumente standarde dhe listë-verifikimi) në sistemin “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Lista e subjekteve të programuara për t’u inspektuar në sistemin “*e-Inspektimi*”, nuk është e njëjtë me listën e subjekteve, të sjellë me shkresë pranë Inspektoratit Qendror për mendim këshillimor.
- ✓ Veprimtaria inspektuese e inspektorateve shtetërore është bashkërenduar dhe koordinuar, duke bërë të mundur uljen e numrit të inspektimeve të panevojshme dhe duke reduktuar kostot administrative ndaj biznesit.
- ✓ Për rritjen e performancës së inspektorateve shtetërore, gjatë kryerjes së veprimtarisë inspektuese online, janë trajnuar dhe ritrajnuar 115 inspektorë shtetërore.
- ✓ Në sistemin “*e-Inspektimi*”, akoma të gjitha inspektoratet shtetërore nuk pasqyrojnë ecuria e masës administrative, (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti), në kundërshtim të pikës 10, të Kreut XIII, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Dokumentet standarde të inspektimit, listë-verifikimi, procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar kanë mangësi në plotësimin e tyre dhe në disa raste nuk ka shpjegime të detajuara për gjetjet e konstatuara.

- ✓ Për rritjen profesionale të inspektorëve, Inspektorati Qendror në bashkëpunim me inspektoratet shtetërore, ku marrëdhënia e punës rregullohet sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, ka bërë vlerësimin dhe testimin për 161 inspektorë.
- ✓ Janë mbështetur nga ana metodologjike 42 njësi administrative të qeverisjes vendore për përshtatjen e dokumenteve standarde, hartimin e listë-verifikimeve dhe implementimin e tyre në sistemin e inspektimeve “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Për inspektimin në fushën e arsimit parauniversitar, mbrojtjes së pyjeve, mbrojtjes nga zjarri, janë përditësuar e listë-verifikimet dhe dokumentet standarde të inspektimit.
- ✓ Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në fushën e ndërtimeve të paligjshme dhe produkteve të ndërtimit; Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve nuk kryejnë ende inspektime online.
- ✓ Pothuajse të gjitha inspektoratet shtetërore nuk kanë realizuar rekomandimet e lëna nga raportet paraardhëse.
- ✓ Regjistri Kombëtar i inspektorëve shtetërorë është mbajtur dhe përditësuar sipas Kreut V, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”, si dhe janë shpërndarë 153 karta të inspektorëve. Ndërsa për inspektoratet vendore nuk janë përditësuar të dhënat e inspektorëve pasi nuk është dhënë informacioni nga njësitë e qeverisjes vendore përkatëse.
- ✓ Janë përgatitur dhe dërguar për propozim 3 (tre) projekt akte, dhe konkretisht një projektligj (“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”) dhe dy projektvendime (“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 696, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*” dhe “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në procesin e inspektimit”);
- ✓ Në kuadër të bashkëpunimit me institucione homologe vendase dhe të huaja, gjatë vitit 2022 u zhvilluan takime dhe tryeza pune me Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm të Kosovës, për shkëmbimin e praktikave më të mira, si dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e inspektimit.

## X. REKOMANDIME

Inspektorati Qendror, gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese të inspektorateve shtetërore dhe trupave të tjera inspektuese, identifikoi disa problematika dhe për përmirësimin e tyre për vitin 2023, rekomandon si vijon:

- ✓ Të hartohet programi vjetor/mujor i inspektimit sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut, për të bërë të mundur parandalimin e rreziqeve që vijnë nga subjektet me rrezikshmëri të lartë, në zbatim të urdhrin nr. 6, datë 19.02.2015, të Inspektorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”;
- ✓ Të bëhet kategorizimi i subjekteve me risk më të lartë, me qëllim identifikimin, parandalimin ose minimizimin e riskut, sipas përcaktimeve të urdhrin nr. 6, datë 19.02.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”.
- ✓ Të kryhet veprimtaria inspektuese online, nëpërmjet tabletës, në mënyrë të tillë që të ndiqet gjurmueshmëria e procesit inspektues dhe dokumentet e gjeneruara në sistem të jenë të nënshkuara nga kryeinspektori, inspektorët dhe subjekti i inspektimit.
- ✓ Të vazhdojë procesi i kryerjes së inspektimeve të përbashkëta nën koordinimin e Inspektoratit Qendror, me qëllim zvogëlimin e kostos administrative ndaj subjekteve të inspektimit.
- ✓ Për përditësimin e Regjistrin Kombëtar të inspektorëve shtetërorë/vendorë, të dërgohet informacioni në kohë pranë Inspektoratit Qendror, për çdo emërim në detyrë ose për çdo lirim nga detyra të inspektorëve, sipas pikës 3 dhe 4, të Kreut V, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”.
- ✓ Të pasqyrohet ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti), në modul “gjoba”, për të gjitha inspektoratet shtetërore/trupat e tjera inspektuese në zbatim të pikës 10, të Kreut XIII, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”.
- ✓ Programi mujor i inspektimit i hedhur në sistemin “e-Inspektimi”, të jetë i njëjtë me programin e inspektimit të paraqitur me shkresë zyrtare pranë Inspektoratit Qendror.
- ✓ Të vazhdojë njoftimi për subjektet e programuara, jo më vonë se 7 ditë para fillimit të procedurës së inspektimit, si dhe të ngarkohet në sistem dokumenti i njoftimit, në zbatim të urdhrin nr. 25, datë 10.08.2018, të Inspektorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, të ndryshuar, përveç se kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm.

- ✓ Të përditësohen listë-verifikimet dhe dokumentet standarde në përputhje me ndryshimet ligjore, sipas fushave përkatëse të inspektimit.
- ✓ Të plotësohen të gjitha rubrikat dhe në mënyrë të saktë, të listë-verifikimit, procesverbalit dhe vendimit përfundimtar të inspektimit, të jepen shpjegime të detajuara për gjetjet e konstatuara, si dhe të këshillohet subjekti i inspektimit për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore. Gjithashtu të evidentohet saktë baza ligjore e shkeljes së konstatuar dhe e masës administrative të marrë.
- ✓ Të plotësohet rubrika “kohëzgjatja e inspektimit” në orë, orën e fillimit dhe mbarimit, në autorizim, procesverbal inspektimi dhe vendim përfundimtar, në zbatim të pikës 2, të nenit 26, të ligjit për inspektimin.
- ✓ Të dokumentohet veprimtaria inspektuese referuar nenit 39, të ligjit nr. 10433/2011, sa më shumë të jetë e mundur me dokumente justifikuese, si foto/video etj, të cilat të ngarkohen në sistemin “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Të vazhdojë mbështetja për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, të cilët akoma nuk kryejnë inspektime online.
- ✓ Të fillojë veprimtaria inspektuese online edhe për inspektoratet vendore, si dhe të implementohen në sistemin “*e-Inspektimi*” ato inspektorate vendore, që nuk janë ende pjesë e këtij sistemi.
- ✓ Të përditësohen website-t e inspektorateve shtetërore dhe të publikohen akte administrative/broshura për subjektet, lidhur me procedurat e inspektimit, për të siguruar njohjen mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre.
- ✓ Të vazhdojë procesi informues sa më shumë të jetë e mundur nga ana e Inspektoratit Qendror për biznesin dhe qytetarët mbi të gjitha aktivitetet në fushën e inspektimit, ndryshimet ligjore të propozuara dhe/ose miratuara, për të qenë transparent dhe efektiv lidhur me detyrimet mbi zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore.